

VENDIM
Nr. 243, datë 17.4.2024

**PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMEVE PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR
KRIMINALITETIT, PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 103, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 32, të nenit 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2024, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë t’ia përcjellë menjëherë rekomandimet prioritare prokurorit të përgjithshëm, si dhe t’ua bëjë ato të njohura drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në një mbledhje të përbashkët, jo më vonë se 1 (një) muaj nga data e miratimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet ministri i Drejtësisë të miratojë metodologjinë mbi mënyrën e vlerësimit dhe ndjekjes në vazhdimësi të zbatimit të rekomandimeve prioritare, bazuar në kritere të përcaktuara qartë dhe të matshme, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MINISTRIA E DREJTËSISË
REKOMANDIME PRIORITARE
NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2024
Tiranë, mars 2024

Mbështetur në ligjin nr. 97/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ministria e Drejtësisë ka përgatitur rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave për prokurorin e përgjithshëm në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024.

Në vijim të praktikës ligjore, administrative dhe institucionale të konsoliduar tashmë, prej rreth 20 vitesh, Ministria e Drejtësisë ka mbështetur veprimtarinë dhe organizimin e organit të prokurorisë në drejtim të: i. rritjes së pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit; ii. forcimit të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; iii. garantimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut; dhe iv. nxitjen e bashkëpunimit ndër-institucional brenda dhe jashtë vendit.

Kryefjala e rekomandimeve edhe për këtë vit vazhdon të mbetet përpjekja e përbashkët e të gjitha institucioneve dhe autoriteteve të strukturuar, si në linjë horizontale, ashtu edhe vertikale, apo në pozitat e politikëbërjes dhe ligjzbatimit, në forcimin e sistemit të drejtësisë në tërësi dhe rolit të organit të prokurorisë në funksion të pushtetit gjyqësor.

Në këtë kontekst, rekomandimet kundër kriminalitetit për vitin 2024 mbështeten në një sërë dokumentesh strategjike¹, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore që normojnë funksionimin e çdo hallke

¹ Programit Qeverisës 2021–2025; Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit; Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024; Planit të Veprimit 2015–2023 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale

të sistemit të drejtësisë, me qëllim koordinimin dhe ndërveprimin e integruar të masave për arritjen e rezultateve të prekshme për vetë sistemin dhe të ndjeshme për qytetarët. Po kështu, në vijimësi është ndjekur nga Ministria e Drejtësisë implementimi i rekomandimeve të dhëna për vitin 2023, duke analizuar dhe vlerësuar përmbushjen e tyre, ndërsa problematikat e evidentuara kanë shërbyer si bazë për të adresuar rekomandime konkrete për vitin 2024². Nën këtë frymë, rekomandimet prioritare që Këshilli i Ministrave i drejton organit të prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024, janë:

i. Garantimi i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë së prokurorit

Rekomandimet për rritjen e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit bazohen në rezultatet konkrete që kanë arritur deri më tani organi i prokurorisë, së bashku me strukturat e tjera mbështetëse të veprimtarisë së prokurorisë. Rritja e treguesve të punës së organit të prokurorisë mbetet sfida kryesore edhe për vitin në vijim.

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka dhënë rezultatet e para të pritshme, pasi një numër i konsiderueshëm procedimesh penale me autorë të dyshuar, që i përkasin nivelit të lartë drejtues ka qenë dhe vijon të mbetet një masë e matshme e rezultateve, si në aspektin e luftës kundër veprave penale të korrupsionit, shpërdorimit të detyrës etj., ashtu edhe në drejtim të forcimit të besimit të publikut te drejtësia e re.

Për vitin 2023 numri i prokurorëve të posaçëm nuk ka ndryshuar, pasi Prokuroria e Posaçme ka vijuar të ketë në përbërje të saj 17 prokurorë nga 20 prokurorë të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 6/2021, “Për përcaktimin e numrit të Prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme”.

Për sa i përket Byrosë Kombëtare të Hetimit, organika prej 60 hetuesish është plotësuar që në vitin 2022 dhe përgjatë periudhës janar–dhjetor 2023, 60 hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit kanë marrë pjesë në 47 trajnime brenda vendit dhe 25 trajnime jashtë vendit të organizuara kryesisht nga ICITAP-i, OPDAT-i, FBI, ILEA-Budapest, CEPOL-i, EUROPOL-i, EU4FOCAL-i etj. Gjithashtu, në vitin 2023 vijnë të mbeten 50 vakanca në pozicionet e shërbimeve të policisë gjyqësore.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka forcuar bashkëpunimin me institucionet e tjera ligzbatuese brenda dhe jashtë vendit, si dhe ka intensifikuar ndërveprimin me autoritetet gjyqësore të huaja dhe me ato vendëse, si me Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimin Informativ Shtetëror, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Ndërsa në nivel ndërkombëtar ka afirmuar rolin dhe pozitën e saj, duke vënë ura bashkëpunimi me organizmat rajonale e ndërkombëtarë, si dhe me partnerët ndërkombëtarë.

kundër Korrupsionit; Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025; Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur dhe të Planit të Veprimit 2022–2026, Raporteve të organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë joqeveritarë, lidhur me monitorime për çështjet e korrupsionit, krimit të organizuar dhe trafikut të lëndëve narkotike, si dhe dokumente të tjera me rëndësi strategjike, si dhe në analizën e të dhënave statistikore të dërguara nga organi i prokurorisë, përgjatë vitit 2023. Gjithashtu, pjesë e përmbytjes së rekomandimeve janë edhe masat e propozuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, si dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të cilat kanë në përbërje të tyre personel me funksionet e policisë gjyqësore.

² Ministria e Drejtësisë, me shkresat e saj nr. 523/9 prot., datë 6.10.2023, dhe nr. 523/10 prot., datë 27.12.2023, i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të Rekomandimeve për vitin 2023. Prokuroria e Përgjithshme ka informuar me shkresat e saj nr. 599/24., datë 29.12.2023, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 523/11 prot., datë 29.12.2023, dhe shkresën nr. 599/40 prot., datë 18.3.2024, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 246/10 prot., datë 18.3.2024. Prokuroria e Posaçme ka përcjellë informacion me shkresat nr. 3415/1 prot., datë 6.3.2024, protokolluar pranë nesh me nr. 246/7 prot., datë 7.3.2024, dhe nr. 4697 prot., datë 19.3.2024, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1673 prot., datë 20.3.2024.

Në lidhje me rekomandimin për garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit, nga të dhënat e përcjella nga organi i prokurorisë³, lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2023, në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, prokurori i përgjithshëm ka nxjerrë një sërë udhëzimesh për zbatim nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Konkretisht janë miratuar: Udhëzimi i përgjithshëm nr. 2/2023, “Për Rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, urdhri nr. 70, datë 12.5.2023, “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023”.

Këto akte nënligjore, u janë dërguar për njohje dhe zbatim prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Po kështu, u është kërkuar informacion lidhur me ecurinë e këtyre rekomandimeve dhe zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023 dhe planit të veprimit të miratuar me urdhrin nr. 70, datë 12.5.2023.

Në udhëzimin e përgjithshëm nr. 2/2023 janë normuar masa për rritjen e rolit aktiv të drejtuesit të prokurorisë, drejtuesit të seksionit dhe prokurorit, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale prioritare të rekomanduara. Evidentohet se në vitin 2023 janë filluar kryesisht 138⁴ procedime penale ose me rritje 11.29% të numrit të procedimeve të filluara, kryesisht krahasuar me vitin 2022. Peshën më të madhe në këto raste e përbëjnë veprat penale të parashikuara në kreun 8: i. seksioni “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”, në masën 56,52%; ii. seksioni II, “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik”, në masën 13,04% e totalit, ku vetëm për “Veprën penale të shpërdorimit të detyrës” janë filluar kryesisht 15 procedime penale ose 10.87% e totalit; dhe iii. seksioni III “Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike” në masën 31.88% e totalit të procedimeve penale të filluara kryesisht; 21.01% e procedimeve janë regjistruar për veprat penale të parashikuara në kreun III, “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, dhe 10.87% për veprat penale të parashikuara në kreun II, “Vepra penale kundër personit”.

Prokurorët në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në bashkëpunim me shërbimet e Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për vitin 2023 kanë kryer hetime proaktive dhe ose/me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në kuadrin e 514⁵ procedimeve penale, duke shënuar kështu një ulje prej 59 procedimesh penale në krahasim me vitin 2022. Ky proces është finalizuar me arrestimin në flagrancë/ndalimin e 474⁶ personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, ku krahasuar me vitin 2022 kemi një ulje prej 111 personash të arrestuar në flagrancë/ndaluar.

Këto hetime proaktive kanë bërë të mundur që të sigurohen të dhëna jo vetëm për veprën penale për të cilën është regjistruar procedimi, por edhe për zbulimin në 6 raste të kryerjes së veprës penale të korrupsionit dhe të korrupsionit aktiv në zgjedhje të parashikuara nga nenet 319, 319/c, 319/ç dhe 328 të Kodit Penal në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme, që ka mundur më pas kryerjen e hetimeve të mëtejshme nga kjo prokurori. Në 9 raste, duke përdorur metoda speciale hetimi, është mundur zbulimi i veprave penale, si: “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, “Falsifikimi i dokumenteve”, “Falsifikimi i dokumenteve shkollorë”, të parashikuara nga nenet 283, 186 dhe 187 të Kodit Penal.

³ Me shkresat e tyre nr. 599/24 prot., datë 29.12.2023 dhe nr. 599/40 prot., datë 18.3.2024, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 523/11 prot., datë 29.12.2023, dhe nr. 246/10 prot., datë 18.3.2024.

⁴ Për vitin 2022 rezulton që janë filluar kryesisht 124 procedime penale, pra 14 procedime më shumë për vitin 2023.

⁵ Për vitin 2022 rezulton që numri i hetimeve proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit ka qenë 573 procedime penale.

⁶ Për vitin 2022 kanë qenë arrestuar në flagrancë 585 persona.

Në zbatim të aktit të koordinimit institucional datë 15.12.2020, “Për rritjen e eficiencës nëpërmjet bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme” ,dhe në zbatim të Kodit të Procedurës Penale për vitin 2023 prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë transferuar 68⁷ procedime/referime, ose me ulje 15% të raportit në përqindje të referimeve të pranuar krahasuar me vitin 2022. Në Prokurorinë e Posaçme janë pranuar 44 procedime/referime ose 64.71% e procedimeve të transferuara për grup-veprat kundër krimit të organizuar dhe të lidhura me korrupsionin ose krimet në detyrë në kompetencë lëndore të asaj prokurorie.

Prokurori i përgjithshëm në nxjerrjen/miratimin e udhëzimit nr. 2/2023 dhe në çdo akt nënligjor dhe dokument të politikave institucionale vendos në themel të ushtrimit të funksionit të prokurorit pavarësinë e tij të brendshme e të jashtme, të sanksionuar mbi të gjitha si parim kushtetues. Këto akte u drejtohen vetë prokurorëve për të mbrojtur dhe ruajtur pavarësinë nga çdo ndikim i paligjshëm në vendimmarrjen e tyre. Nga ana tjetër edhe garantimi i paanshmërisë është parim thelbësor për sistemin e drejtësisë. Prokurori i përgjithshëm vlerëson se trajnimet mbi paanësinë dhe integritetin, parimet e etikës së prokurorit, ndarja e praktikave më të mira apo diskutime të vendimeve të gjykatave kombëtare e ndërkombëtare që trajtojnë këto parime janë qasje për forcimin e integritetit dhe paanësisë së prokurorit.

Prokuroria e Përgjithshme ka mbikëqyrur zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorive, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar, nëpërmjet kërkesave për informacion për zbatimin e tij, dhe jo vetëm, paraqitjes së raporteve vjetore mbi ecurinë e punës në secilën prokurori të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe pjesëmarrjes së prokurorit të përgjithshëm në analizat vjetore të punës së prokurorive për vitin 2022.

Janë evidentuar mangësi në dokumentimin e komunikimeve të ndërsjella të prokurorit me drejtuesin e prokurorisë, për të cilat është tërhequr vëmendja për shmangien e tyre dhe zbatimin e këtij udhëzimi të përgjithshëm të detyrueshëm.

Në kuadrin e forcimit të mekanizmit të kontrollit dhe llogaridhënies në sistemin e prokurorisë, dhe bashkëpunimit ndër-institucional me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, në zbatim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore mbi bazën e një informacioni të Drejtorisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme për një subjekt magjistrat *gjyqtar* pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm ka përgatitur materialin dhe e ka dërguar për shqyrtim dhe vlerësim në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Ndërkohë ankesa e një shtetasi e ardhur në Prokurorinë e Përgjithshme me pretendimin për shkelje të ligjit nga një magjistrat *prokuror* pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, i është dërguar për vlerësim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Një vend të rëndësishëm në garantimin e efektivitetit të sistemit dhe përgjegjësisë së prokurorëve, sigurisht zë ngarkesa e punës, ku për shkak të mungesës reale të 36.33% të numrit organik të prokurorëve, për shkak të mbarimit të statusit, pezullimit ose komandimit në institucione të tjera, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm 1 prokuror mban ngarkesën e 1.6 prokurorëve. Në funksion të ruajtjes së nivelit të eficiencës në veprimtarinë administrative dhe funksionale të prokurorive, garantimin e paanshmërisë, shpërndarjen e ekuilibruar të volumit të punës dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit, me urdhrat nr. 1, datë 18.1.2023, nr. 10, datë 18.1.2023 dhe nr. 89, datë 23.6.2023 të prokurorit të përgjithshëm janë caktuar strukturat organike të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Prokuroria e Përgjithshme gjatë vitit 2023, ka qenë e angazhuar maksimalisht për zbatimin e hartës gjyqësore, duke vijuar bashkërendimin dhe koordinimin me të gjitha prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Ministrinë e Drejtësisë.

⁷ Për vitin 2022 janë transferuar 80 procedime në Prokurorinë e Posaçme.

Për të unifikuar veprimtarinë procedurale dhe mirërregulluar aktivitetin administrativ institucional, u synua ndërhyrja me akte nënligjore të prokurorit të përgjithshëm. Me urdhrin nr. 84, datë 15.11.2022, të prokurorit të përgjithshëm është ngritur grupi i punës për të ndjekur mbarëvajtjen e procesit i cili ka propozuar marrjen e masave administrative në mënyrë që bashkimi i prokurorive dhe mbarimi juridik/mbyllja e disa prokurorive të bëhej në një kohë sa më të shpejtë, duke zgjidhur çdo problematikë të mundshme.

Në fokus të angazhimit ka qenë veçanërisht: i. sigurimi i vazhdimësisë së shërbimeve pa cenuar të drejtat e subjekteve procedurale dhe aksesin e qytetarëve, nëpërmjet miratimit të udhëzimit nr. 1, datë 26.1.2023, “Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm”; ii. planifikimin nëpërmjet ndryshimeve në strukturat organike të burimeve njerëzore, për të siguruar shpërndarjen e numrin të nevojshëm të prokurorëve, të oficerëve të policisë gjyqësore dhe stafit mbështetës, në mënyrë që të garantohet ngarkesë sa më proporcionale e punës; iii. transferimi/bashkimi i shërbimeve, asetëve informatike për gjithë prokuroritë, duke garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e tyre nga humbja, aksesit të tretëve, vijimin e shërbimeve; iv. sigurimin e kapaciteteve akomoduese.

Po kështu, Prokuroria e Përgjithshme, si pjesë e grupit të punës ka ndërmarrë dhe sa vijon: i. ka përfunduar detyra e projektimit nga Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, me Prokurorinë e Përgjithshme, me prokuroritë e shkallës së parë e të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për ndërtimin e një godine të re akomodimi për të gjitha institucionet e sipërcituara, ku aktualisht është në pritje të vënies në dispozicion të një sheshi ndërtimi nga Bashkia Tiranë; ii. kërkohet angazhimi i Ministrisë së Drejtësisë për realizimin e marrëveshjes ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë për vënien në dispozicion të ambienteve akomoduese shtesë/ndërtesa ekzistuese, të cilat më pas do t'i nënshtrohen rikonstruksionit dhe përshtatjes për prokuroritë dhe gjykatat në rrethet Gjirokastrë, Vlorë dhe Durrës.

Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë e të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për të lehtësuar zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm të prokurorit të përgjithshëm nr. 2/2023 kanë nxjerrë udhëzime të përgjithshme dhe/ose urdhra për miratimin e planit të veprimit në kuadrin e rekomandimeve prioritare.

Në udhëzimin e përgjithshëm nr. 10/2021, datë 30.12.2021 dhe udhëzimin e përgjithshëm nr. 2/2023 janë normuar masa administrative dhe procedurale për nxitjen e rolit aktiv të prokurorëve dhe drejtuesve për ushtrimin e kontrollit efektiv të prokurorit, nëpërmjet ushtrimit sistematik të kontrollit efektiv ndaj oficerëve të policisë gjyqësore. Ndërsa për rritjen e rolit të drejtuesit është parashikuar se, drejtuesi i prokurorisë, i cili drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e policisë gjyqësore në rast evidentimi të akteve dhe të sjelljeve, që përbëjnë shkelje disiplinore kërkojnë dhe iniciojnë fillimin e procedimit disiplinor. Prokurori i përgjithshëm, mbi bazën e shkeljeve të evidentuara ka kërkuar fillimin e hetimeve për shkelje disiplinore për 2 oficerë të policisë gjyqësore.

Prokurori i përgjithshëm, me urdhrin nr. 24, datë 14.2.2023, ka krijuar një grup pune me objekt: “Mbi inspektimin tematik për saktësinë në hedhjen e të dhënave në SVHOPGJ, në veprimtarinë e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të policisë gjyqësore në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë”. Në përfundim të inspektimit, rezultoi se nuk është respektuar udhëzimi i Prokurorit të përgjithshëm nr. 10/2021, i ndryshuar, e konkretisht neni 8/a, pika 2, lidhur me hedhjen e të dhënave në sistemin SVHOPGJ nga 23 oficerë të policisë gjyqësore në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë. Në vijim, prokurori i përgjithshëm ka kërkuar zbatimin me korrektesë të udhëzimit të sipërcituar nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore dhe marrjen e masave nga ana e drejtuesve të tyre.

Nga ana tjetër, procesi i plotësimit të këtij sistemi ka nxjerrë në dukje edhe disa problematika teknike për adresimin e të cilave janë marrë masat e duhura dhe prej datës 1 janar 2024 ky sistem i përmirësuar është në funksion.

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional, referuar në informacionin e Komisionit të Policisë Gjyqësore përgjatë vitit 2023, komisioni ka vendosur fillimin e procedimit disiplinor ndaj 7 oficerëve të policisë gjyqësore dhe ka pasur në shqyrtim gjatë këtij viti 2 procedime disiplinore të mbartura nga viti 2022. Nga këta, 6 oficerë të policisë gjyqësore, të proceduar disiplinarisht, u përkasin shërbimeve të policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit, kurse 3 oficerë të policisë gjyqësore u përkasin seksioneve të prokurorisë. Gjatë kësaj periudhe, Komisioni ka përfunduar shqyrtimin e procedimit disiplinor në 4 raste, duke dalë me vendim përfundimtar dhe konkretisht: i. në 1 procedim disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore është dhënë masa disiplinore “Largim nga detyra”; ii. në 1 procedim disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore është dhënë masa disiplinore “Pezullim nga detyra 6 muaj”; iii. në 1 procedim disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”; iv. 1 procedim disiplinor është pushuar për shkak se oficeri i policisë gjyqësore ishte larguar më parë nga detyra me dëshirën e tij. Ndërsa, lidhur me 5 procedime disiplinore të regjistruara gjatë vitit 2023 vijon shqyrtimi i tyre.

Në zbatim të nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 25/2019, dhe procedurave që parashikohen në “Rregulloren për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të oficerëve të policisë gjyqësore”, Komisioni për vitin 2022 ka kryer vlerësimin për 127 oficerë të policisë gjyqësore. Referuar vlerësimeve, komisioni klasifikoi në kategorinë “Shumë mirë” 75 vlerësime; “Mirë” 44 vlerësime, “Mjaftueshëm” 7 vlerësime dhe “I paaftë” 1 vlerësim. Duke qenë se vlerësimi i oficerëve të policisë gjyqësore është një element i rëndësishëm që ndikon në ecurinë në karrierë të tyre, Komisioni bëri ndryshime në “Rregulloren për vlerësimin e oficerëve të Policisë Gjyqësore”, duke parashikuar mekanizma parandalues të vlerësimeve të pambështetura objektivisht në treguesit realë të aktivitetit të policisë gjyqësore nga ana e drejtuesve.

Prokuroria e Përgjithshme e ka vlerësuar si domosdoshmëri forcimin e kapaciteteve profesionale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm dhe e ka trajtuar me prioritet në funksion të eficiencës dhe efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit. Për këtë qëllim është bashkëpunuar me Shkollën e Magjistraturës, me misionet/projektet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e drejtësisë penale, si dhe është bashkërenduar me Komisionin e Policisë Gjyqësore për forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve, nëpërmjet realizimit të trajnimeve. Në kuadrin e trajnimit vazhdues, gjatë vitit 2023 në Shkollën e Magjistraturës janë organizuar dhe zhvilluar 90 tema në fusha të ndryshme, ku kanë marrë pjesë 1074 prokurorë dhe 572 oficerë të policisë gjyqësore. Në kuadrin e disa projekteve dhe aktiviteteve rajonale dhe evropiane, përgjatë vitit 2023, janë përfshirë në trajnime, seminare, *workshope*, tryeza të rrumbullakëta, 130 prokurorë të prokurorisë të juridiksionit të përgjithshëm dhe 73 oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori, sikurse janë, projekti EU4FOCAL, UNODC, projekti IPA 2019, projekti WB CRIM JUST në Eurojust, GIZ, projekti WBCJ, EU4LEA, *Terre des Hommes*. Gjithashtu, mbështetur në “Rregulloren për trajnimin fillestar për hetimin, të oficerëve të policisë gjyqësore”, miratuar nga Komisioni, gjatë vitit 2023 u krye trajnimi fillestar pranë Akademisë së Sigurisë për 17 oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë, të emëruar nga Komisioni i Policisë Gjyqësore.

Prokuroria e Përgjithshme e ka konsideruar thelbësore rritjen e eficiencës së punës, ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve. Për këtë qëllim, me urdhrin e prokurorit të përgjithshëm nr. 4, datë 9.1.2023, është ngritur grupi i punës për përgatitjen e dokumentacionit përkatës për krijimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjes. Prokuroria e Përgjithshme ka zhvilluar takime të vazhdueshme me përfaqësues të Delegacionit Evropian në Tiranë, ku parimisht është rënë dakord për mbështetjen e plotë dhe financimin e sistemit të menaxhimit të çështjes në prokurori

(*software* dhe *hardware*). Krahas ndërlidhjes me bazat e të dhënave të sipërcituara, do të integrohen edhe sistemet ekzistuese që prokuroria ka në funksionim, si IMPRO. Është bashkërenduar puna me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë dhe është hartuar korniza e ndërveprimit të sistemeve të reja të sistemit të drejtësisë, ku përfshihet edhe sistemi CAMS.

Lidhur me kërkesën për shpërndarjen elektronike të çështjeve aktualisht në zbatim të kriterëve ligjore dhe përcaktimeve të udhëzimit nr. 3, datë 29.12.2016, “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, të ndryshuar, prokuroria siguron që nëpërmjet sistemit CAMS të realizohet ndarja e rastësishme e çështjeve në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, duke siguruar transparencë në shpërndarjen e çështjeve dhe garantimin e pavarësisë, e paanshmërisë së prokurorëve në ushtrimin e funksioneve. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, shorti elektronik përdoret sistematikisht në bazë të regjistrimeve të kallëzimeve/referimeve, të cilat shpeshohen mes prokurorëve të seksionit ose prokurorisë përkatëse sipas rastit. Shorti kryhet automatikisht sapo bëhet regjistrimi i kallëzimit/referimit penal, i cili nëpërmjet një algoritmi përzgjedh prokurorin në mënyrë të rastësishme, duke pasur parasysh edhe ngarkesën e prokurorëve të tjerë. Sistemi i ndan në mënyrë të barabartë kallëzimet/referimet penale të regjistruara brenda një seksioni apo prokurorive të caktuara brenda një dite.

Sa më sipër, pavarësisht arritjeve pozitive dhe adresimit të sfidave në vlerësim të prioriteteve të Bashkimit Evropian, politikave në fushën e së drejtës, **me qëllim garantimin e pavarësisë së prokurorit, Këshilli i Ministrave rekomandon:**

1. Vijimin e masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, rekomandim i përsëritur ndër vite, me qëllim shtimin e rasteve të hetimeve, të filluara kryesisht, numër i cili vijon të mbetet i ulët, pavarësisht referimeve të kryera nga strukturat e tjera.

2. Marrjen e masave procedurale dhe administrative për garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve, si dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit.

3. Marrjen e masave për rritjen e kontrollit nga prokurori të punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe shpejtësisë së hetimeve, duke identifikuar dhe trajtuar rastet për përgjegjësi disiplinore.

4. Vijimin e masave për rritjen profesionale dhe organizimin e trajnimeve, si për prokurorët, ashtu dhe për oficerët e policisë gjyqësore, në përputhje me profilizimin e tyre, sipas seksioneve brenda prokurorive, duke mbajtur në konsideratë edhe rekomandimet apo problematikat e konstatuara.

5. Vijimin e masave, me qëllim arritjen e funksionimit optimal të sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve në prokurori (sistemi CAMS), për sa i përket mënyrës së disponimit për çështje konkrete, gjykimet e posaçme, pasqyrimin e saktë të të dhënave në sistemin CAMS në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrolli i vazhdueshëm për saktësinë e paraqitjes së këtyre të dhënave.

ii. Forcimit të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Lufta kundër korrupsionit edhe për vitin 2024 mbetet një nga shtyllat kyçe të rekomandimeve në luftën kundër kriminalitetit. Ky rekomandim mbështetet në rezultatet konkrete të arritura përgjatë vitit 2023, ndërkohë që ende mbetet sfida identifikimi i shpejtë dhe i saktë i autorëve, rrjedhja e informacionit, si dhe sekuestrimi e konfiskimi i aseteve të vëna si produkt i kësaj vepre penale, veçanërisht nga zyrtarë të lartë, kryesisht në investime jashtë vendit.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2023 ka pasur 20 procedime penale të regjistruara për veprën penale të korrupsionit nga funksionarë të niveleve të larta drejtuese, përfshirë ish-zëvendëskryeministër, ish-ministër, si dhe funksionarë të tjerë të administratës shtetërore. Keqmenaxhimi, abuzimi dhe shpërdorimi i fondeve publike ka qenë pasoja kryesore e veprimeve të funksionarëve dhe, për këtë shkak, edhe gjatë vitit 2024, rekomandimi për rritjen e numrit

të çështjeve dhe të personave nën hetim, për këtë kategori mbetet të jetë prioritet. Në krahasim me funksionin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit në nivel të lartë, kjo kategori e veprave penale vazhdon të jetë sfidë edhe për prokurorët e juridiksionit të zakonshëm, për shkak të përhapjes dhe efekteve të këtij fenomeni.

Nga ana tjetër, edhe ndërmarrja e masave për parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e autorëve të veprave penale të krimin të organizuar mbetet sërish në fokusin e rekomandimeve për vitin 2024. Në këtë aspekt, mbetet evident fakti se mjetet, format dhe mënyra e konsumimit të këtyre lloj veprave kanë pësuar evolucion, veçanërisht kur këto lidhen me teknologjinë digjitale, çka sjell edhe vështirësi sa i takon kohës dhe cilësisë së hetimit të tyre. Për rrjedhojë, rritja dhe përsosmëria e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore mbetet sfidë dhe për vitin 2024.

- Lufta kundër korrupsionit

Referuar të dhënave statistikore të marra nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë dhe konkretisht nga Sektori i Rrjetit Antikorrupsion rezulton se për periudhën janar–dhjetor 2023 janë përfunduar 63⁸ raporte përfundimtare nëpërmjet të cilave janë propozuar 177⁹ masa disiplinore dhe janë dhënë 175¹⁰ rekomandime. Gjithashtu, rezultojnë 16¹¹ kallëzime penale me 42 persona të kallëzuar. Krahasuar me vitin 2022,¹² rezulton se janë hartuar 20 raporte më shumë, janë propozuar 82 masa disiplinore më pak, ndërsa numri i rekomandimeve të dhëna mbetet i njëjtë. Referuar numrit të kallëzimeve rezulton se janë bërë 4 kallëzime më pak se në vitin 2022 me 28 persona të kallëzuar më pak.

Po kështu, referuar informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Programeve dhe e Projekteve Antikorrupsion, në cilësinë e Sekretariatit Teknik për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015–2023 dhe Planit të Veprimit 2020–2023, në lidhje me zbatimin e Strategjisë Antikorrupsion për vitin 2023, lidhur me masat e parashikuara për implementim nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme, rezulton se:

Lidhur me treguesin B.1.a **numri i kallëzimeve për korrupsion (rastet dhe personat)**, të zbatuar nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, janë paraqitur të dhëna statistikore dhe rezulton se për vitin 2023, ky tregues është arritur në vlerën 100%. Gjithashtu, edhe lidhur me nëntreguesin **“Raporti i procedimeve për korrupsion të nivelit të lartë” mbi numrin total të kallëzimeve për korrupsion**, janë paraqitur të dhëna lidhur me numrin e procedimeve penale të regjistruara dhe numrin e personave nën hetim/pandehur zyrtarë të nivelit të lartë, si dhe çështjet dërguar në gjykatë ku theksohet se edhe ky nëntregues është arritur në masën 100%.

⁸ Janë përgatitur 41 raporte për ASHK dhe drejtoritë e saj vendore, 3 raporte për AKZM, 1 raport për DRSSH Tiranë, 7 raporte për IKMT (Vlorë, Berat dhe Kukës), 1 raport për DPD, 3 raporte për AKU, 1 raport për QSUNT, 1 raport për AKM, 2 raporte për OSHEE dhe 2 raporte për FSDKSH dhe 1 raport për OSHKSH.

⁹ Janë dhënë 93 masa disiplinore për ASHK dhe drejtoritë vendore të saj, 42 masa disiplinore për AKZM-në, 4 masa disiplinore për DRSSH Tiranë, 11 masa disiplinore për IKMT (Vlorë, Berat dhe Kukës), 22 masa disiplinore për AKU, 2 masa disiplinore për QSUNT, 3 masa disiplinore për AKM, 5 masa disiplinore për OSHEE, 4 masa disiplinore për FSDKSH dhe 3 masa disiplinore për OSHKSH-në.

¹⁰ Janë dhënë 101 rekomandime për ASHK-në dhe drejtoritë e saj vendore, 6 rekomandime për AKZM-në, 6 rekomandime për DRSSH Tiranë, 33 rekomandime për IKMT-në (Vlorë, Berat dhe Kukës), 1 rekomandim për DPD-në, 11 rekomandime për AKU, 2 rekomandime për QSUNT, 3 raporte për AKM, 5 rekomandime për OSHEE, 4 rekomandime për FSDKSH-në dhe 3 rekomandime për OSHKSH-në.

¹¹ Janë bërë 11 kallëzime penale me 26 persona të kallëzuar për ASHK-në, 1 kallëzim penal me 6 persona të kallëzuar për AKZM-në, 1 kallëzim penal me 2 persona të kallëzuar për IKMT-në (Vlorë, Berat dhe Kukës), 1 kallëzim penal me 1 person të kallëzuar për QSUNT, 1 kallëzim penal me 4 persona të kallëzuar për ATP dhe 1 kallëzim penal me 1 person të kallëzuar për OSHEE.

¹² Gjatë vitit 2022 janë hartuar 43 raporte, janë dhënë 259 masa disiplinore, janë dhënë 88 rekomandime, janë bërë 20 kallëzime penale me 70 persona të kallëzuar.

Lidhur me treguesin B.1.b *Numri i kërkesave për sekuestrimin e pasurive në rastet e korrupsionit* – nga ana e Prokurorisë së Posaçme nuk janë paraqitur të dhëna specifike mbi rastet e sekuestrimeve që burojnë nga vepra penale e korrupsionit. Ndërsa lidhur me nëntreguesin B.1.b.1, *“Raporti i kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit në nivel të lartë” mbi numrin total të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit*, Prokuroria e Posaçme nuk raporton specifikisht për rastet e sekuestrimeve apo të konfiskimeve që burojnë nga vepra penale e korrupsionit dhe, për këtë shkak është i pamundur matja e këtij nëntreguesi.

Lidhur me treguesin B.2.a, *“Raporti i procedurave të regjistruara mbi korrupsionin nga referimet e administruara”* nga Prokuroria e Posaçme nuk ka të dhëna specifike mbi referimet e administruara specifikisht për veprën penale të korrupsionit, për këtë shkak është e pamundur matja e këtij treguesi. Ndërsa, lidhur me treguesin B.2.a, *“Numri i aksesit në bazat e të dhënave shtesë për policinë dhe prokurorinë”*, nga ana e Prokurorisë së Posaçme është paraqitur informacion se ka akses në 17 sisteme informacioni apo baza të dhënash shtetërore, ku vlera e synuar për vitin 2023 ishte akses i prokurorisë në 11 databaza, duke treguar se ky tregues është arritur në masën 100%.

- Në përgjigjen e Prokurorisë së Përgjithshme¹³ për zbatimin e rekomandimeve prioritare, rezulton se:

Në kuadër të forcimit të cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit referuar kompetencës lëndore që parashikon neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, ky grup veprash është në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme në bashkëpunim, si me institucionet e reja të luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, ashtu edhe me agjencitë e tjera të specializuara ligjzbatuese.

Prokuroria e Përgjithshme për rritjen e cilësisë dhe eficiencës në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale ka vijuar bashkëpunimin ndër-institucional në nivel vendor dhe qendror, si me Prokurorinë e Posaçme në zbatim të Aktit të Koordinimit Institucional, datë 15.7.2020, ashtu dhe ka vijuar zbatimin i marrëveshjeve dypalëshe të vitit 2020 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Inspektoratin e Lartë të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me synim rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me krimin ekonomik, shpërdorimit të fondeve publike, ushtrimin e veprimtarisë shtetërore në kundërshtim me ligjin.

Në kuadrin e rekomandimeve prioritare, në udhëzimin e përgjithshëm nr. 2/2023 të prokurorit të përgjithshëm janë normuar masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimet paraprake, masa për kryerjen e hetimeve të plota e të gjithanshme, përdorimin e mjeteve të posaçme/speciale të hetimit, duke mbajtur në konsideratë kriteret ligjore për përdorimin e mjeteve të kërkimit të provës, bazuar në marzhet e veprave penale të korrupsionit në kompetencë të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe përdorimin e hetimeve financiare pasurore ose procedimeve pasurore (ndiq paranë) në funksion të rritjes së mëtejshme të efektivitetit në luftën kundër korrupsionit dhe krimeve të lidhura me të.

Prokurorët sipas kërkesave/procedurave ligjore për vitin 2023 kanë rritur rolin aktiv për veprat penale të korrupsionit dhe që lidhen me detyrën, duke filluar kryesisht 18 procedime penale, ndaj 16 procedimeve të filluara në vitin 2022 dhe në kryerjen e hetimeve proaktive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në 31 procedime penale. Ky proces i ka shërbyer finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 7 personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Në kryerjen e hetimeve proaktive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit gjatë vitit 2023 roli aktiv i oficerëve të policisë gjyqësore dhe i prokurorëve përkatës ka mundësuar përfundimin e

¹³ Me shkresën nr. 599/40 prot., datë 18.3.2024, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 246/10 prot., datë 18.3.2024.

të dhënave nga interceptimi të shoqëruara me vëzhgime përtej veprave penale të regjistruara nga prokurori, për të cilat ishte lejuar përgjimi dhe zbulimi në 6 raste të kryerjes së veprave penale të korrupsionit, të parashikuara nga nenet 259, 319/c, 319/ç dhe 328 të Kodit Penal në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme.

Referuar të dhënave statistikore për vitin 2023 për grup-veprat penale të korrupsionit në kompetencë të juridiksionit të përgjithshëm janë regjistruar 170 procedime me 123 të pandehur, ku 140 procedime me 151 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2022 me ulje 35.11% të numrit të procedimeve të regjistruara dhe me ulje 17.16% të numrit të procedimeve të dërguara për gjykim. Gjithashtu, vihet re një rritje prej 30.77% të të pandehurve të dënuar për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

Në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023 dhe të aktit të koordinimit ndërinstitucional mes dy prokurorive, në vitin 2023 sipas të dhënave statistikore dhe të konfirmuara nga informacioni i Prokurorisë së Posaçme janë regjistruar 32 procedime penale për vepra që lidhen me korrupsionin ose vepra penale që lidhen me detyrën, që zënë 47.06% të numrit të referimeve/procedimeve penale të transferuara për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme.

Është në proces finalizimi manuali për hetimin e pastrimit të parave, në të cilin është synuar të trajtohet qasja e mbajtur në udhëzimin nr. 10/2020, që në çdo hetim të veprave penale që sjellin të ardhura të paligjshme është thelbësore të kryhen hetime paralele financiare dhe pasurore, si për konstatimin e kryerjes së veprës penale, ashtu edhe për gjetjen e pasurive që lidhen me veprimtarinë kriminale të personave nën hetim, lidhjet e tyre familjare apo shoqërore që administrojnë pasuritë e dyshuara se rrjedhin nga veprimtaria kriminale.

Për vitin 2023 veçohen 2 raste, ku si rezultat i hetimeve të suksesshme të prokurorive të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm janë sekuestruar apo konfiskuar pasuritë e fituara, si rezultat i veprimtarisë kriminale në fushën e pastrimit të parave të lidhura me veprat penale të korrupsionit dhe për shkak të detyrës. Pas kërkesës për gjykim të prokurorit ndaj 2 shtetasve e konkretisht: i. njëri prej tyre ish-zyrtar i Kadastrës, akuzuar për veprat penale: “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Shpërdorim detyre” dhe “Falsifikim dokumentacioni”, parashikuar nga nenet 248, 186/3 dhe 287 të Kodit Penal, ku gjykata ka vendosur deklarinimin faktor për veprat penale të sipërcituara dhe konfiskimin e dy pasurive të paluajtshme; ii. rasti tjetër është në kuadër të hetimeve ndaj një shtetaseje të akuzuar për kryerjen e veprave penale: “Refuzimi për deklarinimin, mosdeklarinimi, fshehjen ose deklarinimi i rremë i pasurive...”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Deklarata të rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore”, parashikuar nga nenet 257/a, 287 e 305/b të Kodit Penal, ku janë sekuestruar 2 pasuri të paluajtshme.

Edhe në kuadër të luftës kundër korrupsionit, Prokuroria e Përgjithshme e ka vlerësuar si domosdoshmëri forcimin e kapaciteteve profesionale për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve me tema në fushën e korrupsionit e konkretisht: i. korrupsioni aktiv apo pasiv, ku kanë marrë pjesë 6 prokurorë dhe 2 oficerë të policisë gjyqësore; ii. prokurimi publik, ku kanë marrë pjesë 12 prokurorë dhe 6 oficerë të policisë gjyqësore; iii. veprat penale të korrupsionit, teknikat e hetimit, ku kanë marrë pjesë 42 prokurorë dhe 56 oficerë të policisë gjyqësore.

Progresraporti për Shqipërinë 2023¹⁴ për luftën kundër korrupsionit konstaton, se: “*Shqipëria ka një nivel përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit. Pavarësisht disa përparimeve dhe përpjekjeve të vazhdueshme në luftën kundër korrupsionit, ai mbetet një fushë me shqetësim serioz. Organet e SPAK-ur kanë kryer hetime për një sërë çështjesh të nivelit të lartë, duke urdhëruar disa arrestime dhe dënime për një sërë çështjesh të nivelit të lartë. Në përgjithësi, korrupsioni është i përhapur në shumë fusha të jetës publike dhe të biznesit dhe masat parandaluese vazhdojnë të kenë një ndikim të kufizuar, veçanërisht në sektorët vulnerabël. Rritja e numrit të dënimeve përfundimtare në një nivel të*

¹⁴Albania 2023 Report, Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2023 Communication on EU Enlargement Policy.

lartë mbetet një prioritet i rëndësishëm për të trajtuar më tej kulturën e mosndëshkimit. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar ndjekjen e dubur gjyqësore në rastet e verifikimit ku ka indikacione për vepra penale”. Vetingu i gjyqtarëve dhe i prokurorëve vazhdon të sjellë rezultate në luftën kundër korrupsionit brenda gjyqësorit, megjithatë nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar ndjekjen e dubur gjyqësore në rastet e vetingut ku ka indikacione për vepra penale. Rekomandimet e vitit 2022 janë zbatuar vetëm pjesërisht, kështu që ato mbeten të vlefshme”.

Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të *Transparency International* për vitin 2023¹⁵, Shqipëria ka pësuar përmirësim për sa i përket korrupsionit në nivele të larta, duke u rankuar në vendin e 98 nga vendi 101 që ishte në vitin 2022 dhe me një pikë më shumë me 37 pikë nga 36 pikë që kishte në vitin 2022.

Lidhur me problemin e korrupsionit të sistemit gjyqësor, ai vazhdon të perceptohet se është i lartë. Sipas dokumentit “Indeksi i sundimit të ligjit 2023 i *World Justice Project*¹⁶, i cili paraqet një pasqyrë të sundimit të ligjit në 140 vende, duke dhënë rezultatet dhe renditjen sipas vlerësimit nga 0 në 1, Shqipëria renditet në vendin e 91 nga 140 vende. Në lidhje me vlerësimin sipas secilit faktor, për faktorin sistemi i drejtësisë penale, si një aspekt thelbësor për sundimin e ligjit, i cili përfshin të gjithë sistemin penal, Shqipëria është renditur në vendin e 91-të në listë. Në lidhje me faktorin e dytë të vlerësimit – matja e mungesës së korrupsionit – Shqipëria renditet në vendin e 108-të.

- Në përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme¹⁷ për zbatimin e rekomandimeve prioritare rezulton, se:

Konkretisht, për periudhën e vitit 2023 rezulton se¹⁸ nga organi i Prokurorisë së Posaçme janë paraqitur të dhëna statistikore në lidhje me veprat penale që ka në kompetencë lëndore, ku janë hetuar gjithsej 750¹⁹ procedime penale, nga të cilat 451 procedime penale janë mbartur nga viti 2022, ndërsa 299 procedime penale janë regjistruar nga Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2023 si procedime penale të reja. Nga 299 procedime penale të reja të filluara në vitin 2023, 44 procedime penale janë dërguar për kompetencë nga prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe 67 procedime penale janë regjistruar kryesisht nga Prokuroria e Posaçme me 23 persona nën hetim. Për 42 procedime penale është vendosur bashkimi i çështjes, duke shkuar në 708 procedime penale, me 575 persona nën hetim. Krahasuar me të dhënat e pasqyruara në raportin e vitit 2022, rezulton një rritje e numrit të procedimeve të hetuara me 38 procedime më shumë, por vihet re një ulje e numrit të personave nën hetim me 27²⁰ persona më pak, ndërsa numri i procedimeve të regjistruara kryesisht ka një rritje me 39 procedime më shumë, rreth 8,9% e totalit të procedimeve të hetuara.

Gjatë vitit 2023 Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), ka regjistruar gjithsej 447²¹ procedime penale në fushën e korrupsionit, me një numër prej 212 personash nën hetim, shifër kjo që shënon rritje nga viti i kaluar me 25 procedime më tepër, ose rreth 63.1% e veprave penale të regjistruara.

Nga 447 çështje të hetuara nga Prokuroria e Posaçme, për veprat penale në fushën e korrupsionit, 38 çështje janë dërguar me kërkesën për gjykim për 142 të pandehur, nga të cilët 38 persona të pandehur hetuar me masa sigurimi “arrest në burg”; 6 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi

¹⁵ Publikuar në faqen zyrtare të *Transparency International*: <https://www.transparency.org/en/cpi/2023>.

¹⁶ *World Justice project* “Indeksi i sundimit të ligjit 2023, raport vjetor, përgatitur nga një grup ekspertësh vendës dhe të huaj, ka paraqitur të dhënat e administruara nga perspektiva e publikut të zakonshëm, në lidhje me zbatimin e ligjit. Publikuar në faqen web: <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/country/2023/Albania/>.

¹⁷ Me shkresat nr. 3415/1 prot., datë 6.3.2024, protokolluar pranë nesh me nr. 246/7 prot., datë 7.3.2024 dhe nr. 4697 prot., datë 19.3.2024, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1673 prot., datë 20.3.2024.

¹⁸ Raporti Vjetor 2023 mbi Veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

¹⁹ Për vitin 2022 kanë qenë regjistruar 712 procedime penale, ku 257 procedime kanë qenë të regjistruara nga vetë Prokuroria e Posaçme dhe nga ku 28 kanë qenë regjistruar kryesisht.

²⁰ Për vitin 2022 kanë qenë 602 persona nën hetim.

²¹ Për vitin 2022 ishin regjistruar 422 procedime penale.

“arrest në burg në mungesë” (ose 31 persona më pak nga viti i kaluar²²), 22 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “arrest në shtëpi” (ose 5 persona më pak se vitin e kaluar²³), 19 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “detyrim për t’u paraqitur” (ose 5 persona më tepër se vitin e kaluar²⁴), 1 person i pandehur për “ndalimi i daljes jashtë shtetit” (1 person më tepër se vitin e kaluar²⁵) dhe 56 persona të pandehur janë hetuar dhe dërguar në gjykatë pa caktuar ndaj tyre ndonjë masë sigurimi. Krahasuar me vitin e kaluar, rezultojnë 5 çështje më pak të dërguara për gjykim²⁶ dhe 66 të pandehur më pak²⁷.

Për vitin 2023 rezulton se ka përfunduar gjykimi i themelit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 75 çështje penale për veprat penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar me një numër prej 260 të pandehurish. Për 4 çështje penale me 4 persona të pandehur është vendosur shpallja e moskompetencës lëndore dhe janë dërguar për kompetencë në gjykatat e rretheve gjyqësore.

Për vitin 2023 nga Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë dhënë gjithsej 67 vendime dënimi me 233 persona të dënuar, nga të cilat 47 çështje penale me 174 persona kanë qenë për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera, ndërsa 20 çështje penale me 59 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e krimit të organizuar.

Në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2023 janë dhënë gjithsej 57 vendime dënimi me 133 persona të dënuar, nga të cilat 35 çështje penale me 84 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera, ndërsa 22 çështje me 49 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e krimit të organizuar.

Për sa u takon metodave proaktive për ndjekjen e hetimeve penale, Prokuroria e Posaçme përmend se vijon të intensifikohet dhe rritet bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë nëpërmjet krijimit të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, ku vetëm për vitin 2023 janë krijuar 10 prej tyre, nga 25 skuadra të cilat janë aktive në total në Prokurorinë e Posaçme që nga krijimi i saj. Vlen të përmendet se ka pasur rritje të metodave të hetimit proaktiv, në rastin e përgjimeve telefonike, por është rritur, gjithashtu, edhe aplikimi i metodave të posaçme të hetimit, si: vëzhgime, kontrolle, simulime, sekuestro e provave materiale, letërporosi, agjentë të infiltruar, ku përgjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme ka përdorur metodën e përgjimit për 186 procedime penale²⁸, ku janë interceptuar 3335 pajisje fundore, me rritje mbi 52% në të gjithë treguesit krahasuar me vitin 2022.

Lidhur me zbatimin e ligjit antimafia²⁹, nga Prokuroria e Posaçme, për vitin 2023 janë paraqitur në gjykatë 8 kërkesa për sekuestrimin e pasurisë ose 3 kërkesa më shumë se në vitin 2022 të dhëna nga gjykata dhe 9 vendime sekuestrimi pasurie ose 4 vendime më shumë se në vitin 2022. Ndërkohë janë paraqitur në gjykatë 6 kërkesa për konfiskimin e pasurive të sekuestruara, për të cilat janë dhënë nga gjykata 6 vendime konfiskimi, ku krahasuar me vitin e kaluar³⁰ rezulton një ulje e numrit me 4 kërkesa më pak drejtuar gjykatës.

Lidhur me zbatimin e ligjit antimafia³¹, për vitin 2023 ka regjistruar 22 hetime pasurore të reja, krahas hetimeve pasurore të mbartura nga vitet e kaluara, si dhe krahas hetimeve pasurore që bëhen

²² Për vitin 2022 rezultojnë 75 persona me masë sigurimi arrest në burg (pa specifikuar nëse janë në mungesë ose jo).

²³ Për vitin 2022 rezultojnë 27 persona me masë sigurimi arrest në shtëpi.

²⁴ Për vitin 2022 rezultojnë 14 persona me masë sigurimi detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore.

²⁵ Për vitin 2022 nuk ka pasur asnjë person me këtë masë ndaluese.

²⁶ Për vitin 2022 rezultojnë 43 çështje të dërguara për gjykim.

²⁷ Për vitin 2022 rezultojnë 208 persona të hetuar/të pandehur.

²⁸ Për vitin 2022 ishin regjistruar 122 procedime penale me 1023 pajisje fundore.

²⁹ Ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

³⁰ Për vitin 2022 janë paraqitur në gjykatë 5 kërkesa për sekuestrim dhe 10 kërkesa për konfiskim të pasurive të sekuestruara.

³¹ Ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

për çdo çështje penale në kuadër të hetimit penal. Vlera e asetëve të sekuestruara dhe konfiskuara së bashku për vitin 2023 përlllogaritet në vlerën prej 41 milionë eurosh, nga ku 54% e zënë asetet e konfiskuara në vlerën 22.5 milionë euro dhe 46% e zënë asetet e sekuestruara në vlerën 1.9 miliardë lekë.

Prokuroria e Posaçme nënvizon se gama e produkteve të veprave penale të hetuara në kuadrin e pastrimit të parave ka qenë e larmishme, duke përfshirë për herë të parë edhe hetime që lidhen me kriptovalutat dhe sasi të konsiderueshme parash të depozituara në llogari bankare. Për sa u takon procedimeve penale të hetuara në fushën e pastrimit të produkteve penale gjatë vitit 2023, janë hetuar 76 procedime penale (të mbartura dhe të regjistruara), me 53 persona nën hetim, nga të cilat 2 procedime janë dërguar në gjyq, me 8 persona për gjykim dhe 15 të pandehur rezultojnë të dënuar nga gjykata për këtë veprë penale.

Në zbatim të aktit normativ nr. 1, datë 31.1.2020, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”³², janë dhënë nga gjykata 16 vendime për konfiskim pasurie ose 19 vendime më pak se vitin 2022.

Në zbatim të Kodit të Procedurës Penale gjatë procesit penal me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme janë marrë 8 vendime për sekuestrim ose 1 më shumë se viti 2022, ku janë sekuestruar rreth 35 pasuri të paluajtshme, 3 subjekte tregtare, nga të cilët 2 subjekte tregtare të sekuestruara plotësisht dhe kuotat përkatëse të personave nën hetim për 1 subjekt tregtar dhe 16 llogari bankare.

Për vitin 2023, Prokuroria e Posaçme, përveç takimeve koordinuese, në kuadër të skuadrave të përbashkëta nga prokurorët janë kryer 22 trajnime/vizita studimore, janë mbajtur 47 takime/konferenca/forume jashtë vendit kryesisht në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Për vitin 2023, 60 hetuesit e BKH-së kanë marrë pjesë në 47 trajnime brenda vendit dhe 25 jashtë vendit, organizuar nga ICITAP-i, OPDAT-i, FBI-ja, ILEA-Budapest, CEPOL-i, EUROPOL-i, EU4FOCAL-i. Gjithashtu, ICITAP-i gjatë vitit 2023 ka mbështetur Byronë Kombëtare të Hetimit, duke organizuar një sërë trajnimesh të specializuara për përmirësimin e kapaciteteve hetimore, si dhe ka mbështetur të gjithë strukturën e Prokurorisë së Posaçme me mjete logjistike, pajisje elektronike *Software*, sisteme informatike.

Referuar analizës për vitin 2023, që Ministria e Drejtësisë ka kryer në bazë të të dhënave statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme³³, rezulton se:

- Gjatë vitit 2023, janë hetuar 1981 çështje penale për veprat penale në fushën e korrupsionit³⁴, me një numër total prej 223 personash nën hetim dhe janë marrë të pandehur 336 persona. Rezulton se ka një ulje të numrit të hetimeve për veprat penale të korrupsionit në krahasim me vitin 2022, me 148 çështje më pak, ulje të numrit të personave nën hetim me 181 persona më pak nën hetim dhe me ulje 51 persona më pak të marrë si të pandehur, krahasuar me të dhënat e vitit të kaluar³⁵. Për vitin 2023 janë dërguar për gjykim 204 procedime penale ose rreth 10.3 % të çështjeve të hetuara, me 338 të pandehur. Krahasuar me vitin 2022³⁶, konstatohet një ulje e numrit të çështjeve me 26 çështje më pak dhe 54 të pandehur më pak. Për vitin 2023 ka përfunduar gjykimi për 40 çështje penale për veprat penale kundër korrupsionit me një numër prej 91 të pandehurish, nga të cilët janë dënuar 186 persona

³² Miratuar me ligjin nr. 18/2020, datë 5.3.2020.

³³ Me shkresën nr. 1108/36 prot., datë 13.3.2023, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 523/2 prot., datë 13.3.2023.

³⁴ Bazuar në 8 veprat penale në fushën e korrupsionit që kishin mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme (nenet 164/a, 164/b, 248, 256 dhe 257/a, 244/1; 245/1;245/3 dhe 259/1 të Kodit Penal).

³⁵ Për vitin 2022 janë hetuar 2129 çështje penale për veprat penale në fushën e korrupsionit, me një numër total prej 404 personash nën hetim dhe janë marrë të pandehur 387 persona.

³⁶ Për vitin 2022 janë dërguar për gjykim 230 procedime penale me 392 të pandehur.

krahasuar me vitin 2022³⁷, pra rezulton se ka një ulje me 75 çështje, një ulje e numrit me 89 persona të pandehur më pak dhe 34 të dënuar më shumë.

- Ndërsa nga ana tjetër, nëse u referohemi hetimeve proaktive ose hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme, konkretisht në vitin 2023, numri i përgjithshëm i veprave penale të referuara dhe kallëzuara është 38613³⁸, nga të cilat vetëm 138³⁹ janë vepra penale të filluara kryesisht nga prokurori, ose rreth 0,35% e numrit të përgjithshëm. Krahasuar me numrin e çështjeve të regjistruara, kryesisht më 2022-shin, rezultojnë 14 çështje më shumë. Nga 138 çështje penale të filluara, kryesisht nga prokurori, vetëm 18 janë të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit⁴⁰, ose rreth 13% e numrit të çështjeve kryesisht, ku numrin më të madh e zënë çështjet e regjistruara për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me 15 çështje. Gjithashtu, rezultojnë edhe 2 çështje të regjistruara kryesisht për veprën penale të parashikuar nga neni 259/1 të Kodit Penal dhe 1 çështje e regjistruar, kryesisht për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a të Kodit Penal. Nëse i krahasojmë me vitin 2022 për të njëjtat vepra penale në fushën e korrupsionit, rezulton një rritje e lehtë e numrit të çështjeve të filluara kryesisht në fushën e korrupsionit, me 1 çështje më shumë⁴¹.

- Rezulton një ulje e numrit të çështjeve për veprat penale në fushën e pastrimit të parave regjistruar pranë Prokurorisë së Përgjithshme (rreth 35% më pak) krahasuar me të dhënat e vitit 2022. Ndërsa, në total, numri i çështjeve të regjistruara (kryesisht dhe me referim) për veprat penale të pastrimit të parave⁴² është 158 çështje, me një numër total prej 11 personash nën hetim nga të cilët vetëm 4 prej tyre janë marrë si të pandehur. Krahasuar me të dhënat për vitin 2022⁴³, rezulton se ka një ulje të ndjeshme prej 86 çështjesh të regjistruara më pak, ulje e numrit të personave nën hetim me 9 më pak dhe ulje të numrit të të pandehurve me 16 të pandehur më pak.

Duke mbajtur në konsideratë problematikat sa më sipër të evidentuara, prioritetet e përbashkëta, **Këshilli i Ministrave për forcimin e luftës kundër korrupsionit rekomandon:**

1. Rritjen e numrit dhe të cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit, referuar kompetencës lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, duke mbajtur në konsideratë ndarjen e kompetencës lëndore për këto vepra me qëllim garantimin e efektivitetit dhe shpejtësisë në hetimin e çështjeve.

2. Rritjen e rasteve të përdorimit me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit për aq sa është e mundur, vijimin e rritjes së numrit të personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për këto vepra penale, si dhe ndjekjen me vendosmëri të kërkimeve për dënimin e autorëve të këtyre veprave.

3. Rritjen e numrit të hetimeve të çështjeve të filluara kryesisht, rekomandim i përsëritur ndër vite (numri i të cilave vijon të jetë i ulët), me qëllim rritjen e rolit të prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimit.

4. Rritjen e numrit të hetimeve financiare sistematike për veprat penale që gjenerojnë produkte/të ardhura, duke mbajtur në konsideratë fillimin e hetimit financiar paralel në momentin e regjistrimit të procedimit penal.

³⁷ Në vitin 2022, për 8 veprat penale të mbetura në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme kishin përfunduar gjykimin 115 çështje penale me 180 të pandehur, nga të cilët janë dënuar 152 persona.

³⁸ Për vitin 2022, numri i veprave penale të referuar dhe kallëzuara ishte në total 38437.

³⁹ Në vitin 2022, kanë qenë 124 çështje të filluara kryesisht.

⁴⁰ Krahasimi është bërë për 8 veprat penale (nenet 164/a, 164/b, 248, 256 dhe 257/a, 244/1; 254/1;254/3 dhe 259/1 të Kodit Penal).

⁴¹ Në vitin 2022 kanë qenë 17 çështje të filluara kryesisht në fushën e korrupsionit.

⁴² Nenet 287, 287/a dhe 287/b të Kodit Penal

⁴³ Në vitin 2022, për këto tri vepra penale janë regjistruar 244 çështje me 20 persona nën hetim dhe 20 të pandehur.

5. Shtimin e rasteve të gjurmimit të produkteve të veprave penale/aseteve dhe rritjen e numrit të sekuestrimeve/konfiskimeve, përfshirë rastet e tjetërsimit të tyre nga persona të tretë; si dhe bashkëpunimin me institucionet përkatëse për menaxhimin e këtyre produkteve/aseteve.

6. Vijimin e zhvillimit të kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me fokus në luftën kundër korrupsionit me agjencitë e zbatimit të ligjit; si dhe hetimeve pasurore veçanërisht me fokus në format e reja të nxitura nga zhvillimet teknologjike.

- Lufta kundër krimit të organizuar

Rekomandimet në luftën kundër krimit të organizuar vijnë në mbështetjen e nevojës për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve brenda dhe jashtë vendit, me qëllim parandalimin e përçarjes përtej kufijve dhe ndëshkimin brenda vendit me masat më të ashpra dhe më të efektshme për reduktimin e tij. Në këtë drejtim, mbetet prioritet forcimi i kapaciteteve profesionale të agjencive ligjzbatuese dhe zhvillimi i teknikave të reja, me fokus ato kibernetike dhe ndërveprimi me to në nivel rajonal.

Progresraporti 2023,⁴⁴ në lidhje me pastrimin e parave konstaton, se: “Shqipëria vazhdoi përpjekjet e saj për të adresuar mangësitë në përputhshmërinë teknike të identifikuara nga raporti i vlerësimit të ndërsjellë të MONEYVAL 2018. Në raportin e tij të katërt të zgjeruar për Shqipërinë, të publikuar në qershor, MONEYVAL arriti në përfundimin se Shqipëria ka përmirësuar masat e saj për trajtimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ka forcuar transparencën. Ligji për pastrimin e parave është hartuar për t’u përfunduar me acquis të BE-së”. Edhe pse Task Force e Veprimit Financiar vlerësoi se Shqipëria ka përfunduar në mënyrë thelbësore planin e saj të veprimit 2020, vendi mbeti në listën e juridiksioneve të FATF-së nën monitorim të shtuar pasi projektligji i QAP-së (përfshirë një amnisti penale), që Shqipëria u ka dërguar atyre në fillim të vitit 2022, nuk përputhej me parimet apo praktikat më të mira të FATF-së. Në qershor 2023, FATF-ja vendosi të propozojë një vizitë në terren, e cila u zhvillua në gusht dhe çoi në heqjen e Shqipërisë në tetor. Megjithatë, Shqipëria duhet të sigurojë që çdo ligj i ardhshëm (përfshirë amnistitë e mundshme penale) të jetë në përputhje me acquis të BE-së dhe standardet ndërkombëtare”.

- Në përgjigjen e Prokurorisë së Përgjithshme⁴⁵ për zbatimin e rekomandimeve prioritare rezulton se:

Në kuadër të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023, strukturat përkatëse në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë udhëzuar për vijimin e rritjes së mëtejshme të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese brenda vendit dhe rajonale e ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara përfshi ato në fushën e narkotikëve dhe trafikëve, me synim rritjen e cilësisë dhe efektivitetit, si dhe ndjekjes penale ndaj narkotikëve dhe trafikimeve të paligjshme.

Ndjekja penale, politika penale dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit është ndër çështjet prioritare në prokurori, nisur nga cenimi i rëndë i të drejtave të njeriut që karakterizon këtë formë krimi. Prokuroria e Përgjithshme vlerëson se vetëm një qasje e gjithanshme që nis me parandalimin nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit, bashkëpunimit me të gjitha aktorët vendës të përfshirë, bashkëpunimi ndërkombëtar, mbrojtja e viktimave dhe ndjekja penale e dënimi i duhur i autorëve mund të japë rezultate efektive. Në këtë kuadër, Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar në bashkëpunimin me

⁴⁴ “Albania 2023 Report, Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2023 Communication on EU Enlargement Policy”, publikuar më datë 8.11.2023 në faqen:

https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/202311/SĚD_2023_690%20Albania%20report.pdf

⁴⁵ Me shkresën nr. 599/40 prot., datë 18.3.2024, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 246/10 prot., datë 18.3.2024.

projektet ndërkombëtare që mbështesin institucionet shqiptare dhe ato të rajonit për të forcuar hetimin dhe ndjekjen penale të të gjitha formave të trafikimit.

Prokuroria e Përgjithshme ka pasur një bashkëpunim të rëndësishëm me Ministrinë e Brendshme, në kuadër të miratimit të marrëveshjes ndërinstitucionale për forcimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, palë të tjera të së cilës janë ministri e shoqata të shoqërisë civile me rol dhe kontribut në mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Në kuadrin e rekomandimit për vijimin e rritjes së numrit dhe të cilësisë së hetimeve financiare, Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar efektivisht në plotësimin e detyrimeve institucionale në zbatim të Planit të Veprimit të ICRG-së/FATF-së. Në këtë prizëm, gjatë këtyre viteve është rritur dukshëm numri i ndjekjeve penale për veprat penale të pastrimit të parave, si dhe cilësia në hetimin e këtyre veprave penale, janë rritur dënimet dhe konfiskimet lidhur me produktet e veprës penale, janë trajtuar në kohë kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe është konsoliduar sistemi i menaxhimit të çështjeve të pastrimit të parave me të dhëna të përditësuara. Një arritje pozitive në funksion të rritjes së cilësisë në ushtrimin e ndjekjes penale në fushën e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe procedimeve/hetimeve pasurore paralele ka ardhur si rrjedhojë e bashkëpunimit mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave.

Nxjerrja e akteve nënligjore nga prokurori i përgjithshëm, nëpërmjet të cilave janë normuar dhe unifikuar masat administrative dhe procedurale penale në prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, në funksion të rritjes së efektivitetit në hetimet pasurore dhe financiare paralele, për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive produkti i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale, kanë krijuar një bazë solide për rritjen e eficiencës në kryerjen e gjurmimit, hetimit dhe ndjekjes penale të këtyre veprave penale, pasi këto akte krijuan korniza për ngritjen e 7 seksioneve të veçanta dhe caktimin e prokurorëve të dedikuar (44 prokurorë) në prokuroritë vendore të juridiksionit të përgjithshëm, rritjen e kapaciteteve dhe në seksionet e veçanta të drejtorive të policisë vendore, forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese.

Në vitin 2023, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, në kuadrin e hetimit dhe të ushtrimit të ndjekjes penale, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, sipas nenit 287 të Kodit Penal dhe për vepra të tjera penale të lidhura me to, mbi kërkesat e prokurorëve gjykatat kanë vendosur: i. konfiskime pasurie/asetesh kriminale në kuadrin e 6 çështjeve, numër i njëjtë me vitin 2022; dhe ii. sekuestrime pasurie/asetesh kriminale në kuadrin e 24 çështjeve, nga 18 që kanë qenë për vitin 2022.

Në zbatim të nenit 3/1 e vijues të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, në kuadrin e procedimeve/hetimeve pasurore, mbi kërkesat e prokurorëve gjykatat kanë vendosur: i. 8 konfiskime pasurie/asete kriminale; ii. 10 sekuestrime pasurie/asete kriminale nga 7 që ishin në vitin 2022.

Prokurori i përgjithshëm, në cilësinë e përfaqësuesit të autoritetit kompetent ka vijuar zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me EUROJUST, nëpërmjet veprimtarisë së prokurorit ndërlidhës të Shqipërisë në EUROJUST, prania e të cilit ka vijuar konsolidimin e përvojës dhe të kapaciteteve në drejtim të bashkëpunimit, koordinimit të hetimeve dhe shkëmbimit të shpejtë të informacionit me autoritetet gjyqësore të vendeve evropiane dhe rajonit.

Referuar të dhënave nga Zyra e Prokurorit Ndërlidhës Shqiptar në EUROJUST për vitin 2023 janë mbështetur në EUROJUST 5 skuadra të përbashkëta hetimore të reja dhe 17 skuadra të përbashkëta hetimore me autoritetet gjyqësore të huaja, që vijojnë punën e nisur në vitet e mëparshme. Shqipëria ka marrë pjesë në 22 mbledhje koordinuese, si organizuese në 3 prej tyre dhe e ftuar në 19 mbledhje.

Në kuadrin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese ndërkombëtare, në funksion të rritjes së eficiencës dhe efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, nga të dhënat e gjeneruara nga sistemi IMPRO në Prokurorinë e Përgjithshme për vitin 2023 rezulton se janë trajtuar 9 letërporosi nga jashtë për trafikimin e qenieve njerëzore.

Prokurorët për vitin 2023 kanë rritur rolin aktiv në kryerjen e hetimeve proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në 394 procedime penale, vetëm në lidhje me veprat penale kundër trafikëve të paligjshme (narkotikëve, personave, armëve/municioneve), përfshi edhe veprat penale kundër narkotikëve, pastrimit të parave, ndihma për kalim të paligjshëm të personave. Ky proces i ka shërbyer si parandalimit/ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu edhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 325 personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Në vijim të rekomandimit për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, vlen të nënvizohet bashkëpunimi në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit të Prokurorisë së Përgjithshme me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të vitit 2020, “Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve kriminale, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të KSA-së e FATF-së dhe planit të veprimit ICRG/FATF”.

Prokurori i përgjithshëm, në kuadër të bashkëpunimit me organet ligjzbatuese ndërkombëtare në datat 24–27 shtator, zhvilloi disa takime dypalëshe me prokurorët e përgjithshëm të Anglisë dhe të Uellsit, Zvicrës dhe Holandës, të cilat kishin fokus çështje që lidhen me rritjen e eficiencës në drejtim të bashkëpunimit mes prokurorive. Një vëmendje të veçantë ka marrë çështja e transferimit të të dënuarve shqiptarë nga Mbretëria e Bashkuar në Shqipëri, për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit, në kuadër të marrëveshjes së lidhur mes dy vendeve.

Prokuroria e Përgjithshme ka ndërmarrë iniciativën për amendimin e Marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Prokurorit Federal të Belgjikës për bashkëpunim gjyqësor në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, e cila aktualisht është në fazën e diskutimit dypalësh.

Lidhur me rritjen e kapaciteteve profesionale për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, Prokuroria e Përgjithshme ka në fokus të saj zhvillimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve me qëllim rritjen e eficiencës në veprimtarinë e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore dhe forcimin e përgjegjshmërisë. Prokurorët kanë ndjekur trajnimet vazhduese të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës, si vijon: i. trafikimi i qenieve njerëzore, ku kanë marrë pjesë 5 prokurorë dhe 5 oficerë të policisë gjyqësore; ii. shfrytëzimi seksual *online* i të miturve dhe metodat e hetimit, ku kanë marrë pjesë 10 prokurorë dhe 6 oficerë të policisë gjyqësore; iii. urdhri evropian i ndalimit dhe arresti ndërkombëtar, ku kanë marrë pjesë 11 prokurorë dhe 1 oficer i policisë gjyqësore; iv. ekstradimi, ku kanë marrë pjesë 18 prokurorë dhe 7 oficerë të policisë gjyqësore.

Lidhur me rekomandimin “Përditësimin e sistemit statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave dhe aseteve të sekuestruara, për të siguruar tregues efektivë dhe të matshëm të punës së kryer në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin për këto vepra penale janë zhvilluar aktivitete si: i. sistemi *e-Tracking* PRESTO, i krijuar me mbështetjen e projektit Euralius V, vijon të jetë në fokus mbikëqyrjeje, monitorimi dhe zhvillimi nga Prokuroria e Përgjithshme. Për këtë ka vijuar monitorimi i zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 3/2022, datë 6.9.2022, “Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr. 10/2020”, ku ndër të tjera është normuar, se përdoruesit e sistemit duhet të hedhin në kohë reale të dhënat në regjistrin elektronik të sistemit *e-Tracking* PRESTO. Lidhur me

këtë rekomandim që përkon edhe me zbatimin e Planit të Veprimit ICRG/FATF-Shqipëri e konkretisht rezultatit imediate IO.7-1, Prokuroria e Përgjithshme ka marrë masa administrative nëpërmjet nxjerrjes së qarkoreve nr. 887/4, datë 4.4.2022, nr. 887/23, datë 21.6.2023, dhe nr. 1041/3, datë 21.7.2023, drejtuar prokurorive.

Nisur nga rëndësia e sistemit për identifikimin në kohë reale të çdo rasti të pastrimit të parave, Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar edhe asistencën/ndihmën e projektit EU4FOCAL, projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga fondacioni FIIAPP.

Janë paraqitur të dhënat statistikore për veprat penale të trafikimit, prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve, trafikimit të personave dhe trafikimit të armëve. Këto të dhëna janë krahasuar me vitin paraardhës, duke u shprehur dhe nëse ka pasur një rritje apo ulje të numrit të procedimeve dhe të pandehurve. Në lidhje me veprat penale kundër terrorizmit, Prokuroria e Përgjithshme, në përgjigjen e paraqitur është shprehur se ky grup veprash penale, në bazë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, i përket Prokurorisë së Posaçme.

- Në përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme⁴⁶ për zbatimin e rekomandimeve prioritare rezultonte:

Gjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme ka hetuar gjithsej 201 çështje (mbartur dhe regjistruar) për 268 persona nën hetim për veprat penale të krimit të organizuar⁴⁷, pra rezulton një rritje e numrit të procedimeve penale me 34 më shumë se vitin e kaluar. Nga këto janë dërguar për gjykim 11 çështje (ose 1 çështje më tepër se vitin e kaluar⁴⁸) për 109 të pandehur (ose 9 persona më shumë se në vitin 2022⁴⁹), nga të cilat 90 persona të pandehur hetuar me masa sigurimi “Arrest në burg”, 5 persona të pandehur hetuar me masa sigurimi “Arrest në burg në mungesë”, 3 persona të pandehur hetuar me masa sigurimi “Arrest në shtëpi”, 10 persona të pandehur hetuar me masa sigurimi “Detyrim për t’u paraqitur”, 1 person i pandehur me “Detyrimi daljes jashtë shtetit”. Prokuroria e Posaçme ka hetuar 60 vepra penale të tjera në kompetencë të saj sikurse janë veprat me qëllime terroriste, veprat penale të korrupsionit zgjedhor me 95 persona nën hetim.

Prokuroria e Posaçme i ka kushtuar një vëmendje të veçantë veprave penale në fushën e terrorizmit, ku për vitin 2023 janë mbartur dhe regjistruar 28 procedime penale, me 25 persona nën hetim për veprat penale me qëllime terroriste dhe janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 3 procedime penale me 25 persona të pandehur, akuzuar për veprat penale me qëllime terroriste. Ky është një tregues pozitiv, me rritje të rezultateve në krahasim me vitin 2022 ku ishin hetuar 22 procedime penale me 8 persona nën hetim për veprat penale me qëllime terroriste dhe u dërguan në gjykatë me kërkesë për gjykim 3 procedime penale me 3 persona të pandehur, akuzuar për veprat penale me qëllime terroriste. Rezultoni një rritje e çështjeve në hetim me 6 çështje më tepër dhe 17 persona nën hetim më tepër, megjithatë numri i çështjeve të dërguara për gjykim mbetet i njëjtë dhe numri i të pandehurve është ulur me 22 të pandehur më pak krahasuar me 2022-shin.

Për vitin 2023, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë dhënë gjithsej 67 vendime dënimi me 233 persona të dënuar, nga të cilat 20 çështje penale me 59 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e krimit të organizuar, ndërsa 47 çështje penale me 174 persona kanë qenë për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera.

Në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2023 janë dhënë gjithsej 57 vendime dënimi me 133 persona të dënuar, nga të cilat 22 çështje me 49 persona

⁴⁶ Me shkresat nr. 3415/1 prot., datë 6.3.2024, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 246/7 prot., datë 7.3.2024, dhe shkresën nr. 4697 prot., datë 19.3.2024, protokolluar pranë nesh me nr. 1673 prot., datë 20.3.2024.

⁴⁷ Për vitin 2022, kanë qenë regjistruar gjithsej 167 procedime penale.

⁴⁸ Për vitin 2022, rezultojnë 10 çështje të dërguara për gjykim.

⁴⁹ Për vitin 2022, rezultojnë 100 persona nën hetim.

kanë qenë për vepra penale në fushën e krimit të organizuar, ndërsa 35 çështje penale me 84 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera.

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është vlerësuar pozitivisht në luftën kundër pastrimit të parave nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (ICRG) – *Financial Action Task Force* (FATF), e cila në seancën e datës 27.10.2023 miratoi vendimin për daljen e Shqipërisë nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar ose e njohur ndryshe si “lista gri”, duke veçuar kontributin e Prokurorisë së Posaçme dhe rezultatet e saj për IO7 dhe IO8. Duke kryer hetim financiar dhe pasuror paralel për të gjitha kategoritë e veprave penale në kompetencë të saj, si rezultat i tyre ka pasur sukses në kërkesat dhe vendimet për sekuestrime dhe konfiskime. Ka një përmirësim të dukshëm në bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadrin e Eurojust, sikurse është përmendur edhe në rekomandimin nr. II, lidhur me formimin e Skuadrave të Përbashkëta Hetimore. Është rritur ndjeshëm edhe komunikimi i drejtpërdrejtë i Prokurorisë së Posaçme me autoritetet homologe si ato evropiane, Amerikane, gjithashtu edhe me autoritetet homologe të vendeve të Amerikës Qendrore dhe të Amerikës së Jugut. Është rritur ndjeshëm shkëmbimi i informacionit dhe nëpërmjet rrjeteve dhe kanaleve të ndryshme të komunikimit, si: Eurojust, Interpol dhe Europol.

Gjatë vitit 2023, nga ana e Sektorit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta të Prokurorisë së Posaçme, janë hetuar 48 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja, si dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare dhe dypalëshe ku Republika e Shqipërisë është palë. Nga këto janë ekzekutuar 41 kërkesa për ndihmë juridike, kërkesa të cilat janë drejtuar nga ana e autoriteteve gjyqësore të huaja, për kryerjen e veprimeve në Republikën e Shqipërisë lidhur me hetime, në kuadër të veprave penale kryesisht në fushën e korrupsionit, trafikimit të lëndës narkotike, pastrimit të produkteve të veprës penale të veprimtarisë kriminale, mashtrimit, mashtrimit kompjuterik, vjedhje, të kryera në formën e bashkëpunimit të grupit të strukturuar kriminal.

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, një aspekt i rëndësishëm ka qenë edhe nënshkrimi i marrëveshjeve të përbashkëta të bashkëpunimit me prokuroritë e shteteve të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe vendeve fqinje, ku më datë 29.6.2023, është nënshkruar marrëveshja për bashkëpunim ndërmjet Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorit Publik Evropian.

Ndërsa në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, bazuar në ligjin nr. 95/2016, datë 6.10.2016, si dhe në kushtet e ndryshimeve ligjore të bëra në ligjin nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, në vitin 2023 ka vijuar punën me grupin e përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme për hartimin e udhëzimit të përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për formën e kërkesës, procedurën dhe përkthimin e akteve në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjen penale.

Në kuadër të zhvillimit të ndjekjes penale me fokus luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokuroria e Posaçme ka ndërvepruar me agjenci të ndryshme shtetërore për akses në sistemin e të dhënave për qëllim të hetimeve, si:

- Sistemi “ASYCUDA” nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Sistemi “ISSH” nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- Sistemi C@ts nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Sistemi i Fiskalizimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Prokuroria e Posaçme ka vijuar të ndjekë me përparësi ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, i cili do të mbështesë punën e prokurorëve dhe hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, Oficerëve të Policisë Gjyqësore, zyrës së regjistrave dhe protokollit, duke mundësuar përmirësime të rëndësishme të punës së përditshme. Kjo mënyrë ndërveprimi nëpërmjet sistemit do të garantojë

nivelin e nevojshëm të sigurisë dhe sekretit hetimor. Në korrik 2024 do të fillojë faza implementuese dhe testuese e sistemit dhe brenda vitit pritet të përfundojë komplet sistemi së bashku me modulën i cili është ai i raporteve dhe statistikave të cilat do të gjenerohen me të dhënat e sistemit deri në atë moment.

Referuar analizës për vitin 2023 që Ministria e Drejtësisë ka kryer, rezultojnë se:

- Nga analiza e të dhënave statistikore lidhur me veprat penale të trafikimit⁵⁰, për vitin 2023 rezultojnë se janë regjistruar 243 çështje penale me 41 persona në hetim, nga të cilët vetëm 23 janë marrë si të pandehur. Nga këto çështje janë dërguar për gjykim 30 çështje me 41 të pandehur, ose rreth 12.3 % e çështjeve të regjistruara. Numrin më të madh të çështjeve të regjistruara e zë vepra penale “Trafikimi i mjeteve motorike” parashikuar nga neni 141/a i K. Penal me 156 çështje.

- Rezultojnë një rritje e konsiderueshme e numrit⁵¹ të çështjeve të regjistruara me 60 procedime më shumë dhe rritje e numrit të personave nën hetim dhe të personave të marrë si të pandehur me 34 persona më shumë. Lidhur me numrin e çështjeve të dërguara për gjykim për vitin 2023, numri i tyre është rritur me 2 çështje më shumë, po ashtu edhe numri i të pandehurve në gjykim është rritur me 10 persona më shumë krahasuar me vitin 2022⁵².

- Lidhur me veprat penale në fushën e lëndëve narkotike⁵³, në vitin 2023 janë hetuar 3213 çështje penale ose 111 çështje penale më pak se viti 2022. Rezultojnë se janë hetuar 1183 persona dhe janë marrë të pandehur 990 persona. Krahasuar me vitin 2022⁵⁴ rezultojnë ulje me 222 persona të hetuar më pak dhe ulje me 335 të pandehur më pak. Janë dërguar për gjykim 599 çështje ose 18.6 % e çështjeve, me 904 të pandehur, nga ku rezultojnë një ulje krahasuar me vitin 2022 me 154 çështje më pak të dërguara për gjykim dhe 261 të pandehur më pak⁵⁵. Numrin më të lartë të çështjeve në hetim e zë vepra penale: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” neni 283 i Kodit Penal, me 1887 çështje në hetim, nga të cilat janë dërguar për gjykim 476 çështje.

- Lidhur me kategorinë e veprave penale të terrorizmit⁵⁶, rezultojnë se janë regjistruar në total 4 çështje për vitin 2023, ose tri çështje më tepër se në vitin 2022, me asnjë person nën hetim dhe asnjë të pandehur. Në lidhje me çështjet e dërguara për gjykim për këtë kategori veprash për vitin 2023, nuk ka asnjë çështje të dërguar për gjykim. Në krahasim me vitin 2022⁵⁷, mbetemi në të njëjtat shifra.

- Lidhur me veprat penale për nxitjen e urrejtjes dhe pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura⁵⁸ për vitin 2023 janë regjistruar 7 çështje penale për veprën penale “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve”, parashikuar nga neni 265 i Kodit Penal, me 2 persona nën hetim dhe asnjë të pandehur. Rezultojnë se jemi në të njëjtat shifra të çështjeve të regjistruara për këtë grup veprash krahasuar me vitin 2022⁵⁹, dhe kemi 1 çështje të dërguar për gjykim me 1 të pandehur, ose ulje me 2 çështje të dërguara për gjykim dhe me 2 të pandehur⁶⁰ më pak.

- Lidhur me ashpërsimin e politikës penale për veprat penale në fushën e narkotikëve lidhur me masat e sigurimit personal dhe dënimin e tyre, për vitin 2023 nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme nuk është përcjellë informacion, me qëllim krahasimin me vitin paraardhës.

⁵⁰ Nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 138/a, 141/a, 278/a dhe 282/a të K. Penal.

⁵¹ Në vitin 2022 ishin regjistruar 183 çështje penale me 21 persona në hetim, nga të cilët 9 janë marrë si të pandehur.

⁵² Në vitin 2022 ishin dërguar për gjykim 28 çështje me 31 të pandehur për këtë kategori veprash penale.

⁵³ Ku janë përfshirë nenet 283–286/a të K. Penal.

⁵⁴ Në vitin 2022 kanë qenë 3324 çështje të hetuara me 1405 persona nën hetim dhe 1325 të pandehur.

⁵⁵ Në vitin 2022 janë dërguar për gjykim 753 çështje me 1165 persona të pandehur.

⁵⁶ Nenet 230–232/b të Kodit Penal.

⁵⁷ Në vitin 2022 ishte regjistruar 1 çështje penale, me 0 persona nën hetim dhe 0 të pandehur.

⁵⁸ Nenet 265–265/c të K. Penal.

⁵⁹ Në vitin 2022 janë regjistruar 7 çështje penale, me 2 person të marrë nën hetim dhe 1 të pandehur.

⁶⁰ Në vitin 2022 ishte 3 çështje e dërguar për gjykim me 3 të pandehur.

Sa më sipër, **Këshilli i Ministrave ,me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të organizuar rekomandon:**

1. Rritjen e numrit të procedimeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim dhe cilësisë së hetimit për veprat penale në fushën e narkotikëve dhe trafiqeve të paligjshme, si dhe ashpërsimin e politikës së dënimit dhe masave të sigurimit personal për këto vepra penale.

2. Marrjen e masave për evidentimin dhe rritjen e numrit të procedimeve për veprat penale në fushën e terrorizmit, përfshirë dhe rastet e mbrojtjes së sigurisë kombëtare, veçanërisht duke mbajtur në konsideratë zhvillimet ndërkombëtare.

3. Rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve financiare për veprat penale të pastrimit të parave dhe produkteve të veprës penale dhe atë në funksion të rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim, si dhe rritjes së numrit të sekuestrimeve/konfiskimeve.

4. Vijimin e zbatimit të masave për përmbushjen e rekomandimeve të MONEYVAL për pastrimin e parave/luftimin e financimit të terrorizmit, të bashkëpunimit me Eurojust, si dhe të bashkëpunimit rajonal në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore.

5. Marrjen e masave për rritjen e rasteve të përdorimit të teknikave speciale të hetimit, veçanërisht në rastet e hetimeve pasurore, por dhe në rastet e trafikimit dhe krimit të organizuar.

6. Vijimin e forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet strukturave të prokurorisë së juridiksioneve të përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, policisë gjyqësore, policisë së shtetit dhe agjencive të tjera shtetërore, për zbatimin e objektit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike.

7. Vijimin e forcimit të bashkëpunimit me organet ligjzbatuese ndërkombëtare, në kuadër të forcimit të luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe krimeve të tjera të rënda.

8. Rritjen e kapaciteteve profesionale për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore nëpërmjet trajnimeve të posaçme në këtë fushë, duke përfshirë edhe trajnime të përbashkëta me struktura të tjera ligjzbatuese.

9. Përditësimin e sistemit statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave dhe asetëve të sekuestruara për të siguruar tregues efektivë dhe të matshëm të punës së kryer në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin për këto vepra penale.

iii. Garantimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut

Garantimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut mbetet një nga shtyllat kryesore të rekomandimeve edhe për vitin 2024, e fokusuar kryesisht në masat që duhet të merren nga organi i prokurorisë në zhvillimin e sjelljeve dhe qasjeve, në përputhje me standardet më të larta të elaboruara në këtë drejtim nga institucionet vendëse dhe ato evropiane. Këto rekomandime zënë peshë kryesore në kushtet kur tashmë Shqipëria është në procesin e integritimit evropian, duke synuar përafrimin e legjislacionit me standardet e Bashkimit Evropian, në lidhje me garantimin e të drejtave të subjekteve në procesin penal. Për pasojë, respektimi dhe garantimi i të drejtave të tyre, në pozicionin e viktimës, të dëshmitarit sikurse edhe autorit/ëve të veprave penale, mbetet një sfidë për organet e hetimit dhe gjykimin, veçanërisht në trajtimin e subjekteve vulnerabël.

Në përgjigjen e Prokurorisë së Përgjithshme⁶¹ për zbatimin e rekomandimeve prioritare rezulton se:

Lidhur me rekomandimin për vijimin e aplikimit të masave alternative të parashikuara nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (shmangies) rezulton, se Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 8, datë 15.11.2021, “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive për veprat penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitarë”,

⁶¹ Me shkresën nr. 599/40 prot., datë 18.3.2024 protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 246/10 prot., datë 18.3.2024.

veçanërisht dispozitat që normojnë shmangien e të miturve në konflikt me ligjin nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative.

Bazuar në disponimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur janë regjistruar 891⁶² procedime penale, ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin me rritje 8.53% të numrit të procedimeve krahasuar me vitin 2022. Janë regjistruar 746⁶³ të mitur në konflikt me ligjin si të pandehur ose persona nën hetim, ose me rritje 30.42% të numrit të të pandehurve/personave nën hetim të mitur në konflikt me ligjin krahasuar me vitin 2022.

Ndaj të miturve në konflikt me ligjin janë vendosur 16⁶⁴ masa sigurimi personal arrest në burg ose për rreth 4.83% të të miturve të pandehur ose persona nën hetim, tregues në rritje të lehtë krahasuar me 4.38% që përbënte ky raport për vitin 2022. Lidhur me vendimmarrjen e prokurorit për çështjet ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin evidentohet, se: i. është vendosur mosfillimi i procedimit për 603⁶⁵ referime/kallëzime penale ndaj të miturve ose me rritje 7.49% krahasuar me vitin 2022; ii. janë pushuar 353 çështje me 353⁶⁶ të pandehur të mitur ose me rritje 11% të çështjeve të pushuara krahasuar me vitin 2022 dhe janë dërguar për gjykim 178 çështje me 195⁶⁷ të pandehur të mitur në konflikt me ligjin ose me ulje 13.59% të çështjeve të dërguara për gjykim krahasuar me vitin 2022.

Nga të dhënat e përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme për vitin 2023 për prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, numri i çështjeve të përfunduara në zbatim të instituteve të reja procedurale penale⁶⁸ është për 562⁶⁹ çështje, me 573⁷⁰ të pandehur. Në lidhje me këto institute të reja procedurale, rezulton se për 136⁷¹ çështje për kundërvajtje penale është kërkuar miratimi i urdhrin penal me 139⁷² të pandehur, ku krahasuar me 2022-shin rezulton me ulje 46.46% të çështjeve, për 143⁷³ çështje me 148⁷⁴ të pandehur është kërkuar miratimi marrëveshjes për pranimin e fajësisë, ku rezulton ulje me 46.04% të çështjeve të krahasuara me vitin 2022, për 283⁷⁵ çështje me 286⁷⁶ të pandehur është kërkuar gjykimi i drejtpërdrejtë, një rritje me 15.51% të çështjeve krahasuar me vitin 2022.

Lidhur me aplikimin e masave alternative të shmangies, rezulton se, në kuadrin e procedimeve të mosfilluara në 87⁷⁷ raste, është aplikuar shmangia, nga të cilat për 8 raste është vendosur paralajmërim me gojë, në 79⁷⁸ raste është vendosur paralajmërim me shkrim. Ndërkohë, për çështjet e pushuara në 326⁷⁹ raste është aplikuar shmangia ndër të cilat në 2 raste është vendosur këshillim, në 39 raste është

⁶² Për vitin 2022 kanë qenë regjistruar 821 procedime penale.

⁶³ Për vitin 2022 kanë qenë regjistruar 572 të mitur.

⁶⁴ Për vitin 2022 kanë qenë vendosur 25 masa sigurimi personal.

⁶⁵ Për vitin 2022 është vendosur mosfillimi i procedimit për 479 raste.

⁶⁶ Për vitin 2022 kanë qenë pushuar 318 çështje me 281 të pandehur të mitur.

⁶⁷ Për vitin 2022 kanë qenë dërguar për gjykim 206 çështje me 225 të pandehur të mitur.

⁶⁸ Referuar shkresës së Prokurorisë së Përgjithshme nr. 599/40 prot., datë 18.3.2024, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 246/10 prot., datë 18.3.2024.

⁶⁹ Për vitin 2022 ka qenë 764 çështje.

⁷⁰ Për vitin 2022 ka qenë 780 të pandehur.

⁷¹ Për vitin 2022 ka qenë 254 çështje.

⁷² Për vitin 2022 ka qenë 265 të pandehur.

⁷³ Për vitin 2022 ka qenë 265 çështje.

⁷⁴ Për vitin 2022 ka qenë 268 të pandehur.

⁷⁵ Për vitin 2022 ka qenë 245 çështje.

⁷⁶ Për vitin 2022 ka qenë 247 të pandehur

⁷⁷ Për vitin 2022 është aplikuar shmangia në 82 raste.

⁷⁸ Për vitin 2022 në një rast është vendosur paralajmërim me gojë dhe në 70 raste paralajmërim me shkrim.

⁷⁹ Për vitin 2022 për çështjet e pushuara është aplikuar shmangia për 318 raste.

vendosur paralajmërim me gojë, në 282 raste është vendosur paralajmërim me shkrim dhe në 3⁸⁰ raste është caktuar masë detyruese.

Referuar të dhënave statistikore rezulton se janë regjistruar 770 procedime/çështje me 807⁸¹ viktima të mitura, prej të cilëve 346 femra dhe 461⁸² meshkuj, ulje me 7.56% e çështjeve krahasuar me vitin 2022.

Koordinatorët e viktimave në Prokurorinë e Përgjithshme kanë hartuar një manual trajnimi mbi çështjen e dhunës më bazë gjinore, ku rezulton të jenë trajnuar 16 koordinatorë të viktimave të të gjitha prokurorive të rretheve dhe 19 oficerë të policisë gjyqësore.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe për hetimin e ndjekjen penale të krimeve kundër të miturve është organizuar trajnim dyditor në bashkëpunim me UNICEF-in.

Nga të dhënat statistikore të sipërpërmendura rezulton se dy nga institutet procedurale penale: urdhri penal dhe marrëveshja për pranimin e fajësisë kanë pësuar ulje krahasuar me vitin 2022, ndërsa instituti gjykimi i drejtpërdrejtë ka pësuar rritje krahasuar me vitin 2022.

Në lidhje me veprën penale “Krimet seksuale” për vitin 2023 vërehet se janë regjistruar 124⁸³ procedime penale, me ulje prej 23.46% të numrit të procedimeve penale dhe me 69⁸⁴ të pandehur ose me ulje 28.13% të numrit të pandehurve të regjistruar, krahasuar me vitin 2022. Gjithashtu, janë dërguar për gjykim 53⁸⁵ procedime me 58⁸⁶ të pandehur, ku rezulton me ulje prej 39.08% të numrit të procedimeve për gjykim dhe ulje me 38.95% të numrit të të pandehurve krahasuar me vitin 2022.

Lidhur me masat e sigurimit personal, për veprën penale “Krimet seksuale”, rezulton ashpërsim i masave, ku 96.29 %⁸⁷ janë kërkesa për masën e sigurimit “arrest në burg”. E njëjta politikë vërehet edhe në lidhje më kërkesat për caktimin e dënimit për të pandehurit e akuzuar për këto krime, kështu 87.3% e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe 12.7% janë kërkesa për caktimin e alternativave të dënimit me burg. Pra rezulton një rritje të kërkesave për caktimin e dënimit me burgim me 5.6%⁸⁸ dhe ulje të kërkesave të caktimit të alternativave të dënimit më burg me 5.6%⁸⁹.

Në lidhje me veprat penale në fushën e mjedisit⁹⁰, nga të dhënat statistikore në vitin 2023 janë regjistruar 343⁹¹ procedime penale me 73 persona të pandehur⁹² ose me ulje 7.80% të numrit të procedimeve dhe 29.13% të të pandehurve të regjistruar krahasuar me vitin 2022. Janë dërguar për gjykim 60 procedime me 69 të pandehur ose me ulje 20% të numrit të procedimeve dhe ulje 33.01% të të pandehurve të dërguar për gjykim krahasuar me vitin 2022.

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve është zhvilluar edhe trajnim mbi hetimin e veprave penale në fushën e mjedisit organizuar nga projekti EU4LEA me pjesëmarrjen e 1 prokurori. Nga Shkolla e Magjistraturës janë zhvilluar 2 sesione trajnimesh ku kanë marrë pjesë 21 prokurorë dhe 14 oficerë të policisë gjyqësor.

⁸⁰ Për vitin 2022 është vendosur në 6 raste këshillim, në 3 raste paralajmërim me gojë, në 254 raste paralajmërim me shkrim dhe në 1 rast masë detyruese.

⁸¹ Për vitin 2022 kanë qenë regjistruar 833 procedime me 873 viktima të mitur.

⁸² Për vitin 2022 kanë qenë 310 femra dhe 563 meshkuj.

⁸³ Në vitin 2022 janë regjistruar 162 procedime penale.

⁸⁴ Në vitin 2022 kanë qenë 96 të pandehur të regjistruar.

⁸⁵ Në vitin 2022 janë dërguar për gjykim 87 procedime.

⁸⁶ Në vitin 2022 kanë qenë 95 të pandehur të dërguar për gjykim.

⁸⁷ Në vitin 2022 janë 95 % kërkesa për masën e sigurimit “arrest në burg”.

⁸⁸ Në vitin 2022 ka qenë 81.7% kërkesa për caktimit e dënimit me burg.

⁸⁹ Në vitin 2022 ka qenë 18.3% kërkesa për caktimit e alternativave të dënimit me burg.

⁹⁰ Nenet 201-207, nenet 207/a, 207/b, 207/c dhe 207/ç të Kodit Penal, përfshirë ndryshimet e reja të vitit 2021.

⁹¹ Në vitin 2022 janë regjistruar 372 çështje penale.

⁹² Në vitin 2022 janë 51 të pandehur për procedimet penale të regjistruara.

Në lidhje me veprën penale “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, për vitin 2023 janë regjistruar 1396⁹³ çështje penale, me ulje 3.92% të procedimeve krahasuar me 2022-shin, me 1078⁹⁴ të pandehur, me ulje 11.35% të pandehurve të regjistruar krahasuar me vitin 2022. Rezultoni se në vitin 2023 për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal janë dërguar për gjykim 996⁹⁵ çështje për këtë vepër penale me total prej 1048⁹⁶ të pandehur, çka përbën një ulje prej 8.87% e procedimeve dhe 11.33% të të pandehurve të dërguar për gjykim. Çështjet e dërguara në gjyq janë në përqindje më të lartë se ato të pushuara, përkatësisht 71.35% dërguar gjyqit dhe 21.35% të pushuara.

Lidhur me ashpërsimin e politikës penale të dënimit për veprën penale “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, Prokuroria e Përgjithshme është shprehur se kërkesat e prokurorit lidhur me masat e sigurimit për personat që kanë kryer këtë vepër penale janë të ashpra, ku 89.04% janë kërkesa për masa sigurimi me arrest me rritje në krahasim me vitin 2022, ku kërkesat ishin në masën 86.13%. Kërkesat për caktimin e dënimit për të pandehurit e akuzuar për këtë vepër penale rezultojnë se, 61.82%⁹⁷ e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe 38.18%⁹⁸ e kërkesave janë për caktimin e alternativave të dënimit me burg, shifra për afërsisht të njëjta me vitin 2022.

Referuar analizës për vitin 2023 që Ministria e Drejtësisë ka kryer, rezultoni se:

- Nga analiza e të dhënave statistikore, ka rezultuar, se: në çështjet e dërguara për gjykim nga prokuroria për veprën penale “Dhuna në familje”, rezultoni se nuk është kërkuar në asnjë rast dënimi maksimal i parashikuar nga paragrafi përkatës⁹⁹. Gjithashtu, krahasuar me vitin 2022 rezultoni, se: i. në asnjë rast nuk është kërkuar dënimi me gjobë¹⁰⁰; ii. në asnjë rast nuk është kërkuar dënimi sa periudha e paraburgimit¹⁰¹; iii. për 102 të pandehur është kërkuar dënimi minimal i parashikuar nga dispozita¹⁰²; iv. për 287 të pandehur është kërkuar dënimi mesatar¹⁰³; v. në asnjë rast nuk është kërkuar ulja nën minimumin e parashikuar nga dispozita¹⁰⁴; vi. për 240 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të dënimit¹⁰⁵; vii. në asnjë rast nuk është kërkuar tërheqja e akteve¹⁰⁶; viii. në 1 rast është kërkuar pushimi i akuzës¹⁰⁷; ix. për 5 të pandehur është kërkuar pushimi i çështjes¹⁰⁸; dhe x) në asnjë rast nuk është kërkuar pafajësi¹⁰⁹. Për sa më sipër kemi: *ulje* të numrit me 8 raste të dënimit në maksimum, *ulje* me 2 raste të dënimit me gjobë, *ulje* me 3 raste të dënimit sa periudha e paraburgimit, *ulje* me 135 raste më pak të dënimit në minimum, *ulje* me 72 të dënimit mesatar, *ulje* me 149 raste të pezullimit të ekzekutimit të dënimit, *ulje* me 5 raste të pushimit të çështjes dhe *në asnjë rast* nuk është kërkuar tërheqja e akteve dhe pafajësisë njësoj si në vitin paraardhës dhe *ritje* me 1 rast të pushimit të akuzës.

⁹³ Për vitin 2022 ka qenë 1453 çështje penale.

⁹⁴ Për vitin 2022 kanë qenë të pandehur dhe persona nën hetim 1216 persona.

⁹⁵ Për vitin 2022 ka qenë 1093 çështje.

⁹⁶ Për vitin 2022 ka qenë 1182 të pandehur

⁹⁷ Për vitin 2022 ka qenë 61% kërkesat për caktimin e dënimit me burg.

⁹⁸ Për vitin 2022 ka qenë 39 % kërkesave për dënim alternativ.

⁹⁹ Në vitin 2022 dënimi maksimal është kërkuar vetëm në 8 raste

¹⁰⁰ Në vitin 2022 dënimi me gjobë është kërkuar në 2 raste.

¹⁰¹ Në vitin 2022 është kërkuar në 3 raste.

¹⁰² Në vitin 2022 ky dënim është kërkuar për 237 të pandehur.

¹⁰³ Në vitin 2022 ky dënim është kërkuar për 359 të pandehur.

¹⁰⁴ Në vitin 2022 ky dënim nuk është kërkuar në asnjë rast.

¹⁰⁵ Në vitin 2022 pezullimi i ekzekutimit është kërkuar në 389 raste.

¹⁰⁶ Në vitin 2022 tërheqja e akteve nuk është kërkuar në asnjë rast.

¹⁰⁷ Në vitin 2022 pushimi i akuzës nuk është kërkuar në asnjë rast.

¹⁰⁸ Në vitin 2022 për 10 të pandehur është kërkuar pushimi i çështjes.

¹⁰⁹ Në vitin 2022 pafajësia nuk është kërkuar në asnjë rast.

- Lidhur me të miturit viktimë të moshës deri në 18 vjeç rezultoi se për vitin 2023 kemi në total 25 viktimë të mitur të moshës deri në 18 vjeç, nga ku 10 janë meshkuj dhe 15 femra. Për vitin 2022 rezultoi se kanë qenë në total 21 të mitur të moshës deri në 18 vjeç nga ku 9 kanë qenë meshkuj dhe 12 femra. Krahasuar me vitin 2022 kemi rritje të numrit të viktimave të mitur me 4 persona, nga ku 1 viktimë mashkull më shumë dhe 3 viktimë femra më shumë.

- Në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës¹¹⁰ rezultoi se për vitin 2023 janë regjistruar 1494 çështje penale me 380 persona nën hetim dhe janë marrë 734 të pandehur. Krahasuar me vitin 2022¹¹¹ rezultojnë 70 çështje më pak të regjistruara; 14 persona më shumë nën hetim dhe 155 të pandehur më pak. Në lidhje me këtë kategori veprash rezultoi se për vitin 2023 janë dërguar për gjykim 1035 çështje me 1091 të pandehur. Krahasuar me një vit më parë¹¹² ka një ulje prej 93 çështjesh më pak të dërguara për gjykim, dhe 126 të pandehur më pak.

- Po kështu, për veprën penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” neni 79/c i Kodit Penal, në vitin 2023 janë regjistruar 12 procedime penale, me 12 persona nën hetim/të pandehur¹¹³ ose me ulje 14.3 % të procedimeve dhe rritje 20% të pandehurve/personave nën hetim të regjistruar krahasuar me vitin 2022. Janë dërguar për gjykim 10 procedime me 10 të pandehur,¹¹⁴ ose me ulje 9.1% të procedimeve dhe 28.6% e të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë veprë penale, në krahasim me vitin 2022.

- Lidhur me ashpërsimin e politikës penale për veprën penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” neni 79/c i Kodit Penal, nga të dhënat statistikore rezultoi se kërkesat e prokurorit janë 100 % kërkesa për masë sigurimi me arrest, ashtu si dhe në vitin 2022, ndërsa kërkesat për caktimin e dënimit, gjithashtu, rezultojnë të ashpra, e konkretisht, si vijon: 4 kërkesa për burgim të përjetshëm, 2 kërkesa për burgim në maksimumin e dënimit, që parashikon neni 79/c i Kodit Penal.

- Gjithashtu, sa i përket politikës penale në veprat penale të trafikimit të fëmijëve, të dhënat tregojnë se, për vitin 2023 nuk ka kërkesa të prokurorit lidhur me masat e sigurimit personal apo kërkesa për caktim dënimi sepse nuk ka persona nën hetim apo të pandehur dhe as të dënuar. Po kështu, edhe për veprën penale “Trafikimi i të rriturve”, parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal nuk ka asnjë kërkesë për caktim dënimi me burgim, ndërkohë që në vitin 2022 ka pasur vetëm 1 kërkesë.

Këshilli i Ministrave, me qëllim forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut rekomandon:

1. Vijimin e aplikimit të masave alternative të parashikuara nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (shmangies) të të miturit në konflikt me ligjin, për të siguruar një drejtësi miqësore dhe duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të të miturit; si dhe rritjen e efektivitetin e garancive procedurale për viktimat e mitur dhe zbatimin e parashikimeve ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit në konflikt me ligjin.

2. Nxitjen e prokurorëve për rritjen e numrit të rasteve të zbatimit të instrumenteve lehtësuese penale (marrëveshje, urdhri penal) dhe kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë, me synim hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale në një afat sa më të shpejtë, duke mbajtur në konsideratë kompleksitetin, rrezikshmërinë e veprës, si dhe duke ruajtur efikasitetin dhe cilësinë e hetimeve.

3. Vijimin e ashpërsimit të masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve.

¹¹⁰ Seksioni IX, nenet 124–130/a të Kodit Penal.

¹¹¹ Në vitin 2022 ishin regjistruar 1564 çështje me 366 persona nën hetim dhe 889 të pandehur.

¹¹² Në vitin 2022 ishin dërguar për gjykim 1128 çështje me 1217 të pandehur.

¹¹³ Për vitin 2022 kanë qenë regjistruar 14 çështje me 10 persona nën hetim/të pandehur.

¹¹⁴ Për vitin 2022 kanë qenë 11 çështje me 14 persona të pandehur.

4. Forcimin e luftës kundër krimit në familje dhe dhunës ndaj grave dhe ashpërsimin e masave të sigurimit personal dhe dënimit për autorët e veprës penale, veçanërisht atyre recidivistë, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e këtyre grup-veprave.

5. Rritjen e rasteve të aplikimit të dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, personave vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore.

6. Rritjen e vëmendjes ndaj veprave penale në fushën e mjedisit, duke shtuar numrin e çështjeve të hetuara dhe dërguara për gjykim, si dhe bashkëpunimin me institucionet përkatëse referuese.

7. Rritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe veçanërisht të oficerëve të policisë gjyqësore, nëpërmjet trajnimeve veçanërisht për veprat penale me bazë gjinore, seksuale dhe përfshirjen e të miturve, krimin kibernetik dhe veprat penale mjedisore.

iv. Nxitja e bashkëpunimit ndërinstytucional brenda dhe jashtë vendit

Në kuadër të zhvillimit dhe intensifikimit të marrëdhënieve në nivel rajonal dhe ndër rajonal, një nga rekomandimet kryesore për vitin 2024 mbështetet në forcimin e ndërveprimeve dhe komunikimeve me autoritetet hetimore dhe institucionet ligjzbatuese të vendeve të tjera. Nxitja dhe konsolidimi i bashkëpunimit me organizma që veprojnë në fushën e drejtësisë, sikurse me Interpolin, Eurojustin, organet e prokurorisë së vendeve të tjera mbetet sfidë dhe kërkon angazhim dhe vullnet bindës nga ana e organit të prokurorisë për të përçuar më tej veprimet në ndjekjen, hetimin dhe/apo dërgimin në gjyq/ekstradimin të të gjithë autorëve të identifikuar se jetojnë dhe veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Rekomandimet për forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional fokusohen edhe në luftën e përbashkët kundër formave të reja të kriminalitetit, veçanërisht të atyre të lidhur me krimin kompjuterik.

- Në përgjigjen e Prokurorisë së Përgjithshme¹¹⁵ për zbatimin e rekomandimeve prioritare rezulton se:

Lidhur me rekomandimin forcimi i luftës kundër informalitetit, duke rritur numrin e çështjeve të regjistruara e të dërguara për gjykim për grup-veprat penale në fushën e taksave dhe e tatimeve, Prokuroria e Përgjithshme, në kuadër të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023, të Memorandumit të Bashkëpunimit “Për rritjen e efektivitetit që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve kriminale, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të KSA-së e FATF-së dhe planit të veprimit ICRG/FATF” dhe mbikëqyrjes/monitorimit të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 10/2020, drejtuesit e prokurorive janë udhëzuar të koordinojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë efektive për vijimin e rritjes së mëtejshme të luftës kundër krimit financiar dhe hetimeve financiare.

Gjatë vitit 2023, për grup-veprat penale, në lidhje me taksat dhe tatimet¹¹⁶ rezulton se janë regjistruar 187 procedime penale me 55 të pandehur për këto vepra penale¹¹⁷, me ulje prej 40.26 % të numrit të procedimeve të regjistruara krahasuar me vitin 2022. Janë dërguar për gjykim 63¹¹⁸ çështje penale me ulje prej 25.88 % të numrit të procedimeve krahasuar me vitin 2022, si dhe me 156¹¹⁹ të pandehur të dërguar për gjykim, ku krahasuar me vitin 2022 ka një rritje prej 33.33 % të numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim. Ndërsa për veprën penale “Moskryerja e detyrave nga organet tatimore” të parashikuar nga neni 181/a i Kodit Penal nuk rezultoi të jetë regjistruar ndonjë procedim penal, njësoj si në vitin 2022, ndërsa për veprën penale “Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore”, sipas nenit 175 të Kodit Penal, ku përfshihen nëpunësit publik të dyshuar të

¹¹⁵ Me shkresën nr. 599/40 prot., datë 18.3.2024, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 246/10 prot., datë 18.3.2024.

¹¹⁶ Referuar neneve 180-182/a të Kodit Penal.

¹¹⁷ Për vitin 2022 janë regjistruar 313 procedime penale me 48 të pandehur për veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet

¹¹⁸ Për vitin 2022 janë dërguar për gjykim 85 çështje penale.

¹¹⁹ Për vitin 2022 janë 117 të pandehur të dërguar për gjykim.

administratës doganore, janë regjistruar 3 procedime penale, njësoj si në vitin 2022. Ndërkohë, nga analiza e statistikave të prokurorisë për vitin 2023 konstatohet se numri më i madh i referimeve ka ardhur nga policia e shtetit me 31925 çështje të referuara, ndërkohë që referimet e policive të tjera janë si vijon: 10 çështje të referuara nga policia e ndërtimit; 9 çështje të referuara nga policia financiare; 6 çështje të referuara nga policia pyjore; 1 çështje të referuar nga policia elektrike; dhe 467 çështje të referuara nga policitë e tjera.

Krahasuar me vitin 2022¹²⁰, konstatohet se kemi një rritje të referimeve nga Policia e Shtetit me 715 raste më shumë, ulje të referimeve nga policia elektrike me 2 raste më pak rritje nga policitë e tjera me 162 raste më shumë, për policinë financiare rezulton se kemi ulje me 16 raste më pak të referuara, për policinë pyjore kemi rritje me 2 raste më shumë të referuar ndërsa për policinë e ndërtimit jemi në të njëjtat shifra krahasuar me vitin 2022.

Referuar të dhënave statistikore për grup-veprat penale, në lidhje me krimet në fushën e doganave, në vitin 2023, evidentohet se janë regjistruar 242 procedime penale me 211 të pandehur¹²¹ ose me ulje 6.56% e numrit të procedimeve dhe ulje prej 9% të numrit të të pandehurve krahasuar me vitin 2022. Gjithashtu, për këtë grup veprash penale janë dërguar për gjykim 164 procedime penale me 217¹²² të pandehur ose me rritje 22.39 % të numrit të procedimeve dhe rritje 14.21 % të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë grup veprash krahasuar me vitin 2022.

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve në përmirësimin e veprimtarisë hetimore lidhur me këto vepra vlen të përmendet kryerja e trajnimeve “Vepra penale në fushën e tatimeve”, ku kanë marrë pjesë 15 prokurorë dhe 17 oficerë të policisë gjyqësore, si dhe “Përgjegjësia penale e personit juridik” ku kanë marrë pjesë 10 prokurorë dhe 2 oficerë të policisë gjyqësore.

Lidhur me rekomandimin për rritjen e numrit të hetimeve paralele financiare në lidhje me veprat penale në fushën e taksave dhe të tatimeve, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar bashkëpunimin në nivel vendor dhe qendror, me qëllim rritjen e efektivitetit të hetimeve ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal.

Prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm kanë vijuar hetimin paralel financiar lidhur me veprat penale të sipërcituara, ku veçohet 1 procedim penal dërguar për gjykim për veprën penale të “Fshehjes së të ardhurave” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 180/3 dhe 287/2 të Kodit Penal, ndaj 4 shtetasve shqiptarë dhe 9 të huaj, ku shuma totale e transaksioneve bankare të kryera nga llogaritë e 15 kompanive me fushë operimi *Call Center* është në vlerën 5.799.010 euro.

Gjithashtu, në kuadër të një procedimi për veprat penale “Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar” kryer në bashkëpunim, “Dhënie e informacioneve të rreme”, “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve” kryer në bashkëpunim, “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga nenet 144/a e 25, 168, 190/2 dhe 180/1 të Kodit Penal, në korrik të 2023 janë sekuestruar 3 llogari bankare të një shoqërie tregtare në shumat 1.004.474 euro, 13.588.890 lekë dhe 299.925 euro.

Po kështu, në kuadër të një procedimi për veprat penale të parashikuara nga nenet 180, 190 dhe 143 të Kodit Penal, lidhur me lëshimin e faturave fiktive për rimbursim në mënyrë të kundërligjshme të TVSH-së nga shteti në vlerën e 20.765.411 lekë janë duke u hetuar 3 persona juridikë.

Lidhur me rekomandimin për shtimin e vëmendjes për veprat penale në fushën e zgjedhjeve. Prokuroria e Përgjithshme është e angazhuar në garantimin e mbrojtjes juridiko-penale të zgjedhjeve të lira dhe sistemit demokratik të zgjedhjeve, duke marrë masa ligjore institucionale për rritjen e

¹²⁰ Të dhënat për vitin 2022 kanë qenë: 31210 referime nga policia e shtetit; 25 referime nga policia financiare; 10 referime nga policia e ndërtimit; 4 referime nga policia pyjore; nga policia elektrike janë referuar 3 raste dhe 305 referime nga policitë e tjera.

¹²¹ Për vitin 2022 kanë qenë regjistruar 259 procedime penale me 232 të pandehur.

¹²² Për vitin 2022 kanë qenë dërguar për gjykim 134 çështje penale me 190 të pandehur.

efektivitetit të hetimit dhe ushtrimit të ndjekjes penale ndaj autorëve të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira.

Në këtë kuadër, masat institucionale kanë synuar: i. nxjerrjen e akteve normative për të unifikuar organizimin dhe funksionimin e gatishmërisë, hetimin me përparësi të veprave penale që dëmtojnë procesin zgjedhor, bashkërendimin me agjencitë ligjzbatuese për kryerjen e hetimeve proaktive; ii. bashkëpunimin për trajnimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në fushën e zgjedhjeve; iii. angazhimin/përfshirjen e prokurorëve në trajnimin e personelit të policisë kriminale.

Prokurori i përgjithshëm, në kuadër të kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore në prokurori, ka miratuar dhe përcjellë për zbatim qarkoren nr. 516 prot., datë 3.4.2023, “Për masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2023”. Në këtë qarkore iu është kërkuar drejtuesve të prokurorive të rretheve gjyqësore të marrin masa për organizimin dhe funksionimin e gatishmërisë së përfunduar që nga data e fillimit të fushatës zgjedhore deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga KQZ-ja. Në fazën e hetimeve paraprake iu është kërkuar të vlerësojnë dhe të trajtojnë me prioritet dhe në afate optimale çdo referim apo kallëzim për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira apo çdo vepër tjetër penale që dëmton procesin zgjedhor, kryerjen e hetimeve proaktive dhe/ose përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit, si dhe rritjen e intensitetit të hetimeve për këto grupe veprash penale.

Referuar të dhënave statistikore për vitin 2023, rezulton se janë regjistruar 25¹²³ procedime penale dhe 19 të pandehur. Janë dërguar për gjykim 2 procedime penale me 14 të pandehur për veprat penale që cenojnë zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Peshën më të lartë në këto procedime e zënë: i. veprat penale të parashikuar nga neni 328/a, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, për të cilën janë regjistruar 8 procedime penale ose 32% e totalit, dhe ii. vepra penale e parashikuar nga neni 327/a “Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar”, për të cilën janë regjistruar 5 procedime penale ose 20% e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto grupe veprash.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” në Prokurorinë e Përgjithshme janë përcjellë për verifikim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve 45 kërkesa, nga të cilat 33 kërkesa lidhen me kandidatë për anëtarë të Këshillit Bashkiak, 9 kërkesa lidhen me kandidatë për kryetar bashkie, 1 kërkesë për këshilltar bashkiak dhe 2 kërkesa për kryetar bashkie. Nga këto kërkesa për verifikim, për 4 raste është vendosur “Mospranim i kërkesës për verifikim të thelluar”, për 2 subjekte është vendosur “Kthim për plotësim” dhe për 1 subjekt është bërë referim për verifikime të mëtejshme në prokurorinë kompetente.

Lidhur me rekomandimin për rritjen e vëmendjes në lidhje me veprat penale të krimit kibernetik, Prokuroria e Përgjithshme përmend aktivitetet trajnuese të zhvilluara nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, në kuadër të forcimit të kapaciteteve lidhur me veprat penale në fushën e krimit kibernetik.

Lidhur me të dhënat statistikore për grup-veprat penale të krimit kibernetik gjatë vitit 2023 rezulton një rritje prej 22.35% e numrit të procedimeve të regjistruara, nga 255 në 312 procedime penale. Numri i procedimeve të dërguara për gjykim rezulton me rritje, nga 7 procedime në 10 procedime penale, ndërkohë që dhe numri i të pandehurve dërguar për gjykim është rritur nga 13 në 16. Kështu:

i. Lidhur me veprën penale “Pornografia”, parashikuar nga neni 117 i Kodit Penal vërehet rritje me 50% e numrit të procedimeve të regjistruara gjatë vitit 2023, krahasuar me vitin 2022 nga 34 në 51. Sa i përket numrit të procedimeve dërguar për gjykim rezultojnë 2 procedime për vitin 2023 dhe po aq për vitin 2022;

¹²³ Nuk përfshihen veprat penale të korrupsionit në zgjedhje, për të cilat janë regjistruar 4 procedime që i janë përcjellë për kompetencë Prokurorisë së Posaçme.

ii. lidhur me veprën penale “Mashtrimi kompjuterik”, parashikuar nga neni 143/b i Kodit Penal gjatë vitit 2023 janë regjistruar 110 procedime ose rritje 25% ndaj 88 procedimeve penale të regjistruara për vitin 2022. Ndërkohë që procedimet e dërguara për gjykim janë në të njëjtën shifër përkatësisht 5 procedime penale;

iii. lidhur me veprën penale “Falsifikimi kompjuterik”, parashikuar nga neni 186/a i Kodit Penal gjatë vitit 2023, vërehet rritje 17.28% e procedimeve penale të regjistruara e konkretisht nga 81 në 95, ndërkohë që procedimet e dërguara për gjykim janë ulur nga 7 në 4;

iv. lidhur me veprën penale “Hyrja e paautorizuar kompjuterike”, parashikuar nga neni 192/b i Kodit Penal gjatë vitit 2023, vërehet dyfishim i numrit të procedimeve penale të regjistruara nga 10 në vitin 2022 në 20 procedime, ndërkohë që procedimet e dërguara për gjykim janë rritur nga 0 në 1;

v. lidhur me veprën penale “Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike”, parashikuar nga neni 293/a të Kodit Penal gjatë vitit 2023 është regjistruar 1 procedim penal, ndërkohë që në vitin 2022 janë regjistruar 3 procedime penale;

vi. lidhur me veprën penale “Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike”, parashikuar nga neni 293/b të Kodit Penal gjatë vitit 2023, vërehet rritje 30.16% e procedimeve penale të regjistruara, konkretisht nga 63 në 82 procedime, ndërkohë që nuk rezultojnë procedime të dërguara për gjykim;

vii. lidhur me veprën penale “Ndërhyrja në sistemet kompjuterike”, parashikuar nga neni 293/c të Kodit Penal gjatë vitit 2023, vërehet ulje e procedimeve penale të regjistruara e konkretisht nga 9 në 3 procedime, ndërkohë që as për këtë vepër nuk rezultojnë procedime të dërguara për gjykim.

Ndihma e ndërsjellë juridike me autoritetet e huaja është shumë e rëndësishme në hetimin dhe përfundimin e suksesshëm të hetimit të krimit kibernetik. Nga të dhënat rezultojnë 83 kërkesa për ndihmë juridike gjatë vitit 2023, 64 prej të cilave janë letërporosi për jashtë.

Lidhur me rekomandimin për vijimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve ligjzbatuese kombëtare dhe ndërkombëtare, Prokuroria e Përgjithshme për rritjen e cilësisë dhe eficiencës në hetimin dhe në ushtrimin e ndjekjes penale dhe prioriteteve në luftën kundër kriminalitetit ka vijuar dhe ka konsideruar domosdoshmëri qasjen e përbashkët e të unifikuar ndërmjet institucioneve ligjzbatuese. Bashkëpunimi në nivel qendror dhe vendor ka vijuar edhe në kuadër të realizimit të detyrimeve të marra përsipër në marrëveshje të përbashkëta të Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Në janar 2023, ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Brendshme e Bankës së Shqipërisë u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi për rritjen e eficiencës në parandalimin dhe mbrojtjen e monedhave nga falsifikimi dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në këtë fushë.

Sa u përket të dhënave statistikore rezulton se numri i procedimeve penale të regjistruara për veprën penale “Falsifikimi i monedhave”, parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal, ka ardhur në ulje, ku vërehet se janë regjistruar 23 procedime dhe 9 të pandehur gjatë vitit 2023, nga 42 procedime penale dhe 20 të pandehur të regjistruar për vitin 2022.

Në kuadër të angazhimeve të ndërmarra nga Prokuroria e Përgjithshme me Marrëveshjen e Bashkëpunimit lidhur me Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Brendshme, për rritjen e eficiencës në hetimin dhe ndjekjen penale të vjedhjes dhe trafikimit të objekteve të dyshuara si pasuri trashëgimi kulturore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale “Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës” është ulur nga 3 në vitin 2022 në 1 procedim në vitin 2023.

Është dakordësuar në parim dhënia e aksesit në bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit “Për dhënien e së drejtës së aksesit në bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Prokurorisë së Përgjithshme”.

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 28.10.2020, “Për rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, Prokuroria e Përgjithshme ka të drejtën e marrjes së informacionit të drejtpërdrejtë dhe statistikave raportuese të bazës së të dhënave të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

Lidhur me rekomandimin për vijimin e forcimit të kapaciteteve të seksioneve të posaçme pranë prokurorive, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar bashkëpunimin me projektin EU4FOCAL për mbështetjen dhe forcimin e kapaciteteve profesionale fokusuar në seksionet e posaçme në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm ngarkuar me hetimin e ndjekjen penale në fushën e pastrimit të parave. Si më të rëndësishme veçojnë aktivitetin për përgatitjen e manualit për pastrimin e parave me pjesëmarrjen e një grupi pune ndërinstucional, i cili është në fazën përfundimtare të draftimit.

Lidhur me rekomandimin për rritjen e rasteve të përfshirjes në kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore të oficerëve të shërbimeve të tjera të policive gjyqësore, Prokuroria e Përgjithshme shprehet se me udhëzimin e përgjithshëm nr. 2/2023, prokurorët janë udhëzuar për të vlerësuar në çdo rast zbatimin e parimit të specializimit dhe urdhërimin për kryerjen e hetimeve paraprake nga oficerët e policisë gjyqësore të strukturës hetimore përkatëse që ka referuar veprën penale në prokurori.

- Në përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme¹²⁴ për zbatimin e rekomandimeve prioritare rezultojn, se:

Gjatë vitit 2023, nga Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, janë trajtuar 48 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja, ku krahasuar me vitin 2022¹²⁵ rezultojn ulje prej 7 kërkesash më pak.

Nga totali janë ekzekutuar 41 letërporosi ose 2 më shumë krahasuar me vitin 2022. Aktualisht, numri total i kërkesave për vitin 2020–2023 për të cilën vijon ende procedura për ekzekutimin e tyre është 11 kërkesa ose 10 kërkesa më pak se për periudhën 2020–2022.

Gjatë vitit 2023 nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë përpiluar 123 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike drejtuar autoriteteve të huaja, ose 61 më tepër se vjet¹²⁶. Nga këto janë ekzekutuar 54 kërkesa ose 21 kërkesa më shumë se vitin e kaluar¹²⁷, si dhe po vijon procedura për ekzekutimin e 83 kërkesave për vitin 2020–2023 ose 35 kërkesa më shumë se në periudhën 2020–2022¹²⁸.

Për vitet 2020–2023 janë krijuar 32 Skuadra të Përbashkëta Hetimore¹²⁹ (ose 22 më shumë se për periudhën 2021–2022), në funksion të hetimeve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nga të cilat 25 skuadra të përbashkëta hetimore janë aktive dhe 10 prej tyre janë krijuar në vitin 2023, në funksion të hetimeve për veprat penale, të: i. trafikimit të narkotikëve; ii. pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale; iii. falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose i vizave; iv. ndihma për kalim të paligjshëm; v. vepra të kryera në formën e bashkëpunimit të veçantë të grupit të organizuar dhe strukturuar kriminal, parashikuar nga Kodi Penal në nenet 283/a, 28, 287, 189, 298, 333/a dhe 334.

¹²⁴ Me shkresat nr. 3415/1 prot., datë 6.3.2024, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 246/7 prot., datë 7.3.2024, dhe shkresën nr. 4697 prot., datë 19.3.2024, protokolluar pranë nesh me nr. 1673 prot., datë 20.3.2024.

¹²⁵ Për vitin 2022 janë trajtuar 54 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike.

¹²⁶ Për vitin 2022 janë 62 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore të huaja nga Prokuroria e Posaçme.

¹²⁷ Për vitin 2022 janë 33 kërkesa të ekzekutuara.

¹²⁸ Për vitin 2022 janë 48 kërkesa në proces.

¹²⁹ Për vitin 2020–2023 janë 5 skuadra të përbashkëta me Italinë, 1 skuadër me Kosovën, 1 skuadër me palë Finlandën, 1 skuadër me Francën dhe 2 skuadra me Maqedoninë e Veriut.

Gjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka bërë shpalljen në kërkim ndërkombëtar për 72 persona (ose 30 më shumë se vitin e kaluar¹³⁰), si dhe ka transmetuar pranë Ministrisë së Drejtësisë 39 kërkesa për ekstradim nga jashtë vendit në Shqipëri (ose 29 kërkesa më shumë se vitin e kaluar¹³¹), kryesisht për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet (283/a, 297, 333/a, 334, 258-25, 298/3, 28/5, 319-25, 232/a, 189, 190, 79/dh, 278/1, 28/4, 109, 152, 130/a/1, 139, 80, 245-25 të Kodit Penal).

Edhe gjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është asistuar në punën e saj nga disa programe të SHBA-së, të cilat synojnë përmirësimin e drejtësisë kriminale të Shqipërisë dhe sektorit të zbatimit të ligjit, Programi Tejoqeanik i Ndihmës dhe i Trajnimit të Zhvillimit të Prokurorisë, (OPDAT), Programi Ndërkombëtar i Ndihmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal (ICITAP), përfaqësues të të cilave janë të vendosur dhe fizikisht në ambientet e kësaj prokurorie.

Një tjetër aspekt i punës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar ka qenë dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të përbashkëta të bashkëpunimit me prokuroritë e shteteve të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe vendeve fqinje, ku më datë 29.6.2023 është nënshkruar Marrëveshja për Bashkëpunimin ndërmjet Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Shqipërisë dhe Prokurorit Publik Evropian.

Lidhur me veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës gjatë vitit 2023 kanë përfunduar verifikimet e plota të pasurisë dhe pastërtisë së figurës për 60 kandidatë për personel administrativ në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Gjatë këtij viti komisioni ka filluar dhe ka vazhduar procesin e verifikimit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës edhe për 13 kandidatë për gjyqtarë në gjykatat e posaçme. Në këtë proces kanë përfunduar verifikimet edhe për 2 kancelarë të gjykatave të posaçme të shkallës së parë dhe apelit. Pra, përfundimisht, Komisioni ka përfunduar raportet e verifikimit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës për 60 subjekte dhe vazhdon verifikimet për 95 subjekte.

Në kuadër të veprave penale që lidhen me zgjedhjet, për periudhën 1.1.2023–31.12.2023 rezulton se numri i materialeve kallëzuese/referuese është 53 (ose 99 materiale më pak se në vitin 2022¹³²) nga të cilat për 10 është vendosur mosfillim procedimi (ose 10 më pak se vitin e kaluar), për 3 materiale është vendosur mospranimi i akteve dhe ridërgimi i tyre pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për 4 materiale është vendosur dërgimi për kompetencë në prokuroritë e rretheve gjyqësore (ose 46 më pak se vitin e kaluar) ndërsa për 36 materiale është vendosur regjistrimi i procedimit penal (ose 27 më pak se vitin e kaluar).

Për vitin 2023 janë hetuar gjithsej 50 procedime penale për 17 persona nën hetim, nga të cilat: i. 8 procedime janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim me 16 të pandehur me masë sigurimi për 2 persona “arrest në burg”, 2 persona “arrest në shtëpi” dhe 4 persona “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”; ii. 6 procedime janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim; iii. 2 procedime janë transferuar për kompetencë në prokuroritë e rretheve; iv. 1 procedim është pezulluar; v. 1 procedim është bashkuar me procedimet e tjera. Aktualisht, në hetim janë 32 procedime penale me 1 person nën hetim.

¹³⁰ Për vitin 2022 kanë qenë 42 persona.

¹³¹ Për vitin 2022 kanë qenë 10 persona.

¹³² Në vitin 2022 kanë qenë 152 materiale.

Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale për vitin 2023 janë ekzekutuar 79 vendime gjykatë të formës së prerë ose 24 vendime më shumë se vitin e kaluar dhe janë dënuar 269¹³³ të pandehur ose 62 të dënuar më shumë se vitin e kaluar. Nga këto vendime 22 kanë marrë formë të prerë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe 57 vendime kanë marrë formë të prerë në Gjykatën e Posaçme të Apelit.

Nga vlerësimi i rekomandimeve të propozuara nga Ministritë e linjës që kanë në përgjegjësi agjencitë ligjzbatuese, që ushtrojnë funksione të policisë gjyqësore, evidentohet progres i arritur dhe forcimi i bashkëpunimit me organin e prokurorisë. Me qëllim përmirësimit e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, nga këto institucione janë propozuar si vijon:

Ministria e Brendshme¹³⁴ në përputhje me prioritetet e përcaktuara në programin e Qeverisë, dhe me masat e marra në kuadër të integritetit evropian të Shqipërisë, të cilat synojnë të përmbushin standardet dhe rekomandimet e FATF/MONEYVAL dhe Planin e Veprimit të ICRG/FATF për vitin 2024 si edhe në Memorandumin e Bashkëpunimit Ndërinstitucional nr. 5270, datë 16.7.2020, *“Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale në funksion të përmbushjes së Rekomandimeve të KSA-së dhe Planit të Veprimit të ICRG/FATF”*, ka paraqitur sugjerimet me qëllim: *i. rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit; ii. parandalimin dhe goditjen e aktiviteteve të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimet ekonomike e financiare, dobësimin e financave të rrjeteve të krimit të organizuar; iii. forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me prokurorinë.*

Konkretisht Ministria e Brendshme sugjeron:

i. Zhvillimin e hetimeve pasurore paralelisht me hetimin penal referuar ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*, veçanërisht në hetimet e grupeve të strukturuar kriminale, dhe subjektet e shpallura në kërkim ndërkombëtar, duke synuar që për këto subjekte të kërkohet sekuestrimi i pasurisë që në fazën fillestare të hetimit.

ii. Rritjen e numrit të hetimeve të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë, në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe të grupeve kriminale me aktivitet kombëtar dhe ndërkombëtar.

iii. Të zbatohen kërkesat e Memorandumit të Bashkëpunimit, korrik 2020, për realizimin e takimeve dhe analizave të përbashkëta ndërinstitucionale prokurori–polici, në nivel qendror dhe lokal, me qëllim evidentimin, adresimin, zgjidhjen e problematikave.

iv. Të vijojë mbështetja për implementimin e shkëmbimit të të dhënave midis dy aplikacioneve të Menaxhimit Policor të Çështjes së Policisë së Shtetit dhe Menaxhimit të Çështjes së Prokurorisë.

v. Të vlerësohet rishikimi i udhëzimit të përbashkët nr. 2487, datë 15.5.2017, *“Për trajtimin e bimëve, lëndëve narkotike apo psikotrope dhe prekursorëve kimikë të sekuestruara”*, lidhur me procedurën e administrimit të këtyre provave.

vi. Të mundësohet prioritizimi i trajtimit të provave biologjike, duke iu kushtuar vëmendje më të madhe provave biologjike për ngjarjet e rënda, për shkak të kufizimeve financiare për reagjentët e nevojshëm për të kryer këto ekspertime, që bëjnë të pamundur kryerjen e të gjithë ekspertimeve të kërkuara të ADN-së.

Ministria e Financave dhe konkretisht Agjencia e Inteligjencës Financiare¹³⁵, duke mbajtur në konsideratë edhe konkluzionet e (FATF/ICRG), rekomandon:

¹³³ 160 persona me burgim, 91 persona me kusht, kohë prove, 10 persona me orë pune, 2 persona me gjobë.

¹³⁴ Kërkuar informacion me shkresën nr. 246/1 prot., datë 17.1.2024, ardhur përgjigje me shkresat e tyre nr. 755/1 prot., datë 19.2.2024, protokolluar me nr. 246/3 prot., datë 21.2.2024.

¹³⁵ Kërkuar informacion me shkresat nr. 246/1 prot., datë 17.1.2024, nr. 246/5 prot., datë 23.2.2024, nr. 246/8 prot., datë 11.3.2024, nr. 246/11 prot., datë 26.3.2024, kthyer përgjigje me shkresën e tyre nr. 4063 prot., datë 27.3.2024, protokolluar pranë nesh me nr. 246/12 prot., datë 29.3.2024.

- Rritjen e fokusit për dërgimin në gjykim të procedimeve penale për veprën penale të parashikuar në nenin 287 të Kodit Penal, me fokus të veçantë sekuestrimet në fushën e krimit të organizuar apo korrupsionit, si dhe analizimin e rasteve të revokimit të sekuestrimit/konfiskimit nga gjykatat.

- Realizimin e takimeve periodike nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm me të gjitha institucionet e ngarkuara dhe kryerjen e analizave për evidentimin e problematikave të procedimeve penale.

- Ngritjen e sistemit të menaxhimit të rasteve, me qëllim zëvendësimin e sistemit aktual të përdorur nga prokurorët për të menaxhuar dhe ndjekur ecurinë e rasteve, si dhe shtimin e kapaciteteve logjistike dhe teknologjike për të.

- Forcimin e kapaciteteve të strukturës së prokurorive dhe oficerëve të policisë gjyqësore që janë dedikuar për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, krimit ekonomik dhe krimit kibernetik.

Ministria e Financave dhe konkretisht Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve¹³⁶ rekomandon:

- Veprat penale në fushën e tatimeve t'iu delegohen strukturave të specializuara të hetimit tatimor, me qëllim kryerjen me cilësi dhe në një kohë sa më të shpejtë të hetimeve. Kjo, me qëllim verifikimin paraprak të rasteve, duke shmangur problematikën e paraqitur nga disa prokurori në lidhje me plotësinë e provave të cilat mbështesin referimin dhe rastet e flagrancës, kur referimi bëhet nga struktura të tjera policore.

- Rritjen e bashkëpunimit me strukturat e inspektorëve të hetimit tatimor edhe në rastet e veprave penale, të referuara nga institucione të tjera ose që nuk i përkasin fushës së taksave apo tatimeve, por për të cilat është e nevojshme kryerja e verifikimeve dhe marrja e informacionit në administratën tatimore.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit¹³⁷ ka paraqitur problematikën në lidhje bashkëpunimin me prokurorinë për vitin 2023, konkretisht:

- Nga ana e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve (AKP) janë konstatuar problematikën lidhur me zhvillimin e një hetimi të plotë dhe marrjen në përgjegjësi penale të autorëve për procedimet penale, që lidhen me veprat penale në fushën e pyjeve, si në rastin e transportit ilegal të lëndës drusore. Në lidhje me një hetim sa më të plotë, rekomandohet bashkëpunim midis strukturave përgjegjëse të pyjeve, policisë së shtetit me strukturat e prokurorisë për sa u përket: *i. dëmtimeve nga prerjet e pyjeve; ii. dëmtimeve të pyjeve dhe të kullotave nga zjarrvëniet; iii. dëmtimeve nga gërryerjet për inerte të lumenjve; iv. dëmtimeve nga aktivitetet e paligjshme të subjekteve private.*

- Nga ana e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) janë paraqitur statistikën në lidhje me referimet e 208 rasteve të shkaktimit të dëmeve në zonat e mbrojtura mjedisore dhe të gjitha rastet janë referuar në organet e tjera ligjzbatuese, nga të cilat 165 raste pranë IKMT-së. Nga administratat rajonale e zonave të mbrojtura janë paraqitur 41 kallëzime penale, për dëmet e konstatuara në zonat e mbrojtura mjedisore. Për sa më sipër, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura rekomandohet rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional, me qëllim rritjen e efikasitetit të zbatimit të ligjshmërisë në zonat e mbrojtura.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit gjithashtu rekomandon: i. organizimin e trajnimeve kombëtare të strukturave përgjegjëse të pyjeve, Policisë së Shtetit dhe prokurorëve për hetimin e krimeve mjedisore sipas praktikave më të mira evropiane, si dhe pjesëmarrjen e këtyre të fundit në

¹³⁶ Kërkuar informacion me shkresat nr. 246/1 prot, datë 17.1.2024, nr. 246/5 prot., datë 23.2.2024, nr. 246/8 prot., datë 11.3.2024, nr. 246/11 prot., datë 26.3.2024, kthyer përgjigje me shkresën e tyre nr. 4063 prot., datë 27.3.2024, protokolluar pranë nesh me nr. 246/12 prot., datë 29.3.2024.

¹³⁷ Kërkuar informacion me shkresën nr. 246/1, datë 17.1.2024, kthyer përgjigje me shkresën e tyre nr. 487/2 prot., datë 20.2.2024, protokolluar pranë nesh me nr. 246/2 prot., datë 21.2.2024.

trajnime e konferenca ndërkombëtare, që lidhen me krimet në mjedis dhe pyje, nisur nga fakti që Prokuroria e Përgjithshme është anëtare e rrjetit ENPE, Rrjetit Evropian të Prokurorëve Mjedisorë.

Ministria e Mbrojtjes¹³⁸, për vitin 2024 rekomandon: i. rritjen e trajnimeve të oficerëve të policisë gjyqësore, në varësi të kësaj ministrie; si dhe ii. forcimin e rolit të Oficerëve të Policisë Gjyqësore pjesë e Komandës së Forcës Detare/Rojës Bregdetare, sipas përcaktimit ligjor të attributeve të tyre.

Sa më sipër, **Këshilli i Ministrave, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional rekomandon:**

1. Rritjen e numrit të çështjeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim, për grup-veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve, duke forcuar bashkëpunimin me institucionet përkatëse, si dhe rritjen e numrit të hetimeve paralele financiare, në lidhje me veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve, si vepra penale që gjenerojnë të ardhura, gjurmimin e produkteve dhe rritjen e numrit të sekuestrimeve/konfiskimeve.

2. Rritjen e vëmendjes në lidhje me veprat penale të krimit kibernetik, duke mbajtur në konsideratë zhvillimet teknologjike dhe përhapjen e lartë të këtyre veprave, në lidhje me cilësinë e hetimit dhe ndjekjen penale të autorëve.

3. Rritjen e numrit të hetimeve proaktive për veprat penale në fushën e krimeve financiare, pastrimit të parave, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore, si dhe për veprat penale të fushës së krimeve të rënda që mund të lidhen me format e veçanta të bashkëpunimit.

4. Rritjen e rasteve të përfshirjes në kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore të oficerëve të shërbimeve të tjera të policive gjyqësore, sidomos për rastet e referuara në prokurori prej tyre dhe marrjen e masave për forcimin e bashkëpunimit dhe zgjidhjen e problematikave.

5. Vijimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve ligjzbatuese kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e cilësisë dhe të eficiencës në hetimin dhe në ushtrimin e ndjekjes penale, shkëmbimin e të dhënave dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë dhe të gjithanshëm.

6. Vijimin e forcimit të kapaciteteve të seksioneve të posaçme pranë prokurorive me qëllim rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve për veprat penale në kompetencë të këtyre seksioneve, si dhe shtimin e kapaciteteve profesionale bashkë me oficerët e policive gjyqësore, sipas kategorive të veprave penale.

¹³⁸ Kërkuar informacion me shkresën nr. 246/1 prot., datë 17.1.2024, kthyer përgjigje me shkresën e tyre nr. 940/1 prot., datë 27.2.2024, protokolluar me nr. 246/6 prot., datë 28.2.2024.